



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

**RAPORT I VEPRIMTARISË TË PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË**

**VITI 2024**

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM: ORNELA BENA

N/PREFEKTI POGRADEC: LUAN MAXHARI

N/PREFEKTI KOLONJË: ADRIATIK BRAÇE

N/PREFEKTI DEVOLL: HENRIK RUSI

S.P.P.E.C.K: ZARIF BIBA

S.F.SH.M: VASJANA MANO

S.M.K.V.F.D: LEDIA BONJA

S.J: DORJAN KAÇORI

S.ZH.U: GJERGJI NAÇI

**P R E F E K T I**

**NERTIL JOLE**

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT VJETOR 2024

<b>1.</b>	<b>Hyrje: .....</b>	<b>Faqe 3 – 4</b>
<b>2.</b>	<b>Përshkrim i objektivave 2024: .....</b>	<b>Faqe 5</b>
<b>3.</b>	<b>Veprimtaritë e institucionit: .....</b>	<b>Faqe 6 – 14</b>
<b>4.</b>	<b>Nënprefektura Pogradec: .....</b>	<b>Faqe 15 – 18</b>
<b>5.</b>	<b>Nënprefektura Kolonjë: .....</b>	<b>Faqe 18 – 20</b>
<b>6.</b>	<b>Nënprefektura Devoll: .....</b>	<b>Faqe 20 – 23</b>
<b>7.</b>	<b>Spektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile e Krizave: .....</b>	<b>Faqe 23 – 31</b>
<b>8.</b>	<b>Spektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse: .....</b>	<b>Faqe 31 – 35</b>
<b>9.</b>	<b>Spektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore e Funksioneve të Deleguara: .....</b>	<b>Faqe 35 – 43</b>
<b>10.</b>	<b>Spektori Juridik: .....</b>	<b>Faqe 43 – 47</b>
<b>11.</b>	<b>Spektori i Zhvillimit Urban: .....</b>	<b>Faqe 47 – 51</b>
<b>12.</b>	<b>Zyrat e Arkivit të Gjendjes Civile: .....</b>	<b>Faqe 51</b>
<b>13.</b>	<b>Problematika: .....</b>	<b>Faqe 51 – 52</b>
<b>14.</b>	<b>Objektivat 2025: .....</b>	<b>Faqe 53</b>

## I: Hyrje:

Si përfaqësues i qeverisë brenda territorit administrativ të qarkut të Korçës, Prefekti i Qarkut në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe Degët Territoriale ndjek, zbaton dhe koordinon të gjitha detyrimet e parashikuara me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut, *ndryshuar me ligjin nr. 36/2024, datë 18.4.2024.*

Përmes bashkëpunimit të ngushtë me të gjithë aktorët vendorë, institucioni i Prefektit luan rolin e një hallke lidhëse ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, forcave të rendit dhe strukturave të mbrojtjes, duke siguruar që politikat dhe masat për sigurinë e qytetarëve dhe stabilitetin e komunitetit të jenë të efektshme dhe të mirëkoordinuara në çdo nivel të administrimit publik.

Drejtimi ynë kryesor institucional ka të bëjë me ndjekjen dhe zbatimin e programit dhe politikave specifike të qeverisë për qarkun e Korçës në fusha kyçe si turizmi, arsimi, shëndetësia, bujqësia, siguria publike dhe mbrojtja civile.

- **K.V.S.P-të:** Krijimi i KVSP-së si një detyrë e re për Prefektin, rrit përgjegjësinë e tij për mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve në nivel vendor dhe ndihmon në forcimin e lidhjes ndërmjet institucioneve qendrore dhe komunitetit. Në zbatim të këtij detyrimi ligjor në fillim të muajit dhjetor 2024, kemi kërkuar zyrtarisht nga bashkitë e qarkut, marrjen e masave për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, duke propozuar ngritjen e K.V.S.P-ve në çdo bashki brenda afatit 3-mujor të përcaktuar në pikën 18 të V.K.M-së nr.678/2024, afat i cili përfundon në datën 1 shkurt 2025.

**Turizmi:** Ndjekja e zbatimi i politikave dhe prioritetëve të vendosura nga qeveria për turizmin, si dhe zbatimi e monitorimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Qendrushëm të Turizmit, ka qenë një nga detyrat që Institucioni i Prefektit ka pasur në fokus gjatë kësaj periudhe. Institucioni ka një rol drejtues e koordinues në këtë drejtim nëpërmjet Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit (KRZHT), Task-Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik veror, grupeve të monitorimit në terren, bashkëpunimit dhe bashkërendimit me NJVV-të dhe institucionet e përfshira, përgatitjes së planit të masave për ecurinë e çdo sezoni turistik veror apo dimëror, etj. Vitet e fundit si rezultat i investimeve dhe mbështetjes me projekte nga qeveria është rritur ndjeshëm numri i strukturave akomoduese me standarte të larta (160 të tilla funksionojnë në Qark). Përmendim se përgjatë vitit 2024 rreth 600.000 turistë që kanë vizituar Qarkun.

- **Bujqësia dhe Agroturizmi:** Korça ka patur një traditë të gjatë bujqësore dhe si e tillë ka qenë në vëmendjen e qeverisë shqiptare, duke hartuar programe dhe projekte të cilat kanë mbështetur zhvillimin e agroturizmit dhe përmirësimin e infrastrukturës bujqësore. Kemi koordinuar dhe monitoruar implementimin e skemave subvencionuese për fermerët dhe mbështetjen për rritjen e prodhimeve lokale, duke e bërë rajonin tonë të njohur për produktet e tij të freskëta dhe tradicionale.

- **Arsimi:** Në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe Ministrinë e Arsimit, është monitoruar zbatimi i politikave arsimore, duke përfshirë cilësinë e infrastrukturës shkollore, procesin mësimor dhe nismat për rritjen e kapaciteteve arsimore në qark. Projekte të rëndësishme të qeverisë janë zbatuar dhe po zbatohen për rikonstruksionin e një numri të

konsiderueshëm të shkollave në të gjithë territorin e qarkut, ku përmendim se vetëm gjatë vitit 2024 ka përfunduar rikonstruksioni i plotë në 7 (shtatë) shkolla të Qarkut.

- Infrastruktura Rrugore: Politikë tjetër kryesore e qeverisë që vazhdon të implementohet në qarkun e Korçës është përmirësimi i infrastrukturës rrugore nacionale dhe bashkiake. Lidhur me këto, institucioni ynë ka mbikëqyrur projektet për rehabilitimin e rrugëve nacionale dhe bashkiake, ku përmendim përfundimin e punimeve në aksin Korçë – Ersekë, aksin rrugor Maliq-Lozhan i Ri-Strelcë, dy segmentet rrugore rurale të zonës së Mokrës, "Ndërtimi i rrugës Pogradec-Tushemisht-Doganë Loti 2", realizimi i rikonstruksionit të segmentit Arrëz-Nikolicë, segmenti Sinicë-Dardhë etj.

Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile: Sipas përcaktimeve të ligjit për Prefektin ushtrojmë rolin tonë për koordinimin dhe menaxhimin e masave për mbrojtjen civile në rast të fatkeqësive natyrore ose emergjencave, me qëllim të sigurojmë që plani i mbrojtjes civile është në funksion dhe mobilizon kapacitetet vendore në rastet e emergjencave civile. Nga institucioni janë zhvilluar takime të vazhdueshme me Komisionet e Mbrojtjes Civile të bashkive dhe Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel Prefekturë, të cilat kanë synuar përgatitjen dhe mbajtjen në gatishmëri të kapaciteteve operacionale, saktësimin e veprimeve dhe radhës së punës që do të ndiqet në varësi me situatat problematike që mund të krijohen, si dhe ndërhyrja në kohë për të ulur efektete e pasojat negative që mund të shkaktohen nga fatkeqësi të ndryshme. Gjatë sezonit veror nuk patëm raste ekstreme përveç zjarrit në bashkinë Maliq (Bode, Gorë) ku u angazhuan 450 forca dhe 65 automjete, si dhe rastit të zjarrit në Parkun Kombëtar të Prespës ku u angazhuan 600 forca, 82 automjete si dhe u përdor ndihma e ushtrisë dhe mekanizmit evropian të EC.

- Degët Territoriale: Në mbështetje të ligjit për Prefektin, mbajmë kontakt të vazhdueshëm, koordinojmë dhe monitorojmë detyrat e degëve territoriale të institucioneve qendrore në qarkun e Korçës për të siguruar që shërbimet publike janë të disponueshme dhe cilësore për qytetarët. Në këtë kuadër ushtrojmë përgjegjësinë institucionale në lidhje me mbikëqyrjen e këtyre degëve për zbatimin e detyrimeve ligjore dhe përgjegjësive të deleguara sipas afateve të përcaktuara nga institucionet qendrore.

- Marrëdhëniet me NJVV-të: Si përfaqësues i qeverisë në qarkun e Korçës, në zbatim të përcaktimeve ligjore kemi patur bashkëpunim të ngushtë me bashkitë në territorin e qarkut për të siguruar që shërbimet publike dhe programet e zhvillimit janë në përputhje me prioritetet e qeverisë dhe nevojat e komunitetit. Ky bashkëpunim ka përfshirë koordinimin në çështje si përmirësimi i infrastrukturës, turizmi dhe bujqësia. Institucioni ynë është angazhuar në dhënien e ndihmave dhe orientimeve për harmonizimin e projekteve lokale me objektivat kombëtare.

- Mjedisi dhe Zonat e Mbrojtura: Nisur nga objektivi institucional për sigurimin në nivel qarku të marrjes të masave mbajtjen pastër të mjedisit, është punuar për realizimin e detyrave të përcaktuara nga institucionet qendrore duke bashkërenduar punën dhe siguruar një nivel të mirë të masave të marra për pastrimin dhe higjienizimin e territorit. Gjithashtu një vëmendje e veçantë i është kushtuar Zonave të Mbrojtura, ku është kërkuar rritja e bashkëpunimit ndër-institucional si dhe ruajtja e shtimi i vlerave në këto Zona.

## 2: Objektivat 2024:

Mbështetur në përcaktimet e Ligjit Nr.107/2016, datë 14.11.2016 “Për Prefektin e Qarkut” si dhe në Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit të Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë miratuar me Urdhërin Nr.119, datë 15.12.2020 të titullarit, objektivat për vitin 2024 për Prefektin e Qarkut Korçë ishin si më poshtë vijon:

1. Ndjekja dhe marrja e masave për plotësimin nga të gjitha institucionet në qark, (*Institucione Qëndrore në nivel vendor, Bashki dhe Këshilli i Qarkut*) të detyrimeve që ata kanë për të garantuar sovranitetin, rendin kushtetues dhe shëndetin public dhe zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave në nivel qarku.
2. Mbikqyrja, kontrolli dhe bashkërendimi e veprimtarisë së institucioneve qëndrore në nivel vendor, si dhe të këtyre me organet e qeverisjes vendore, Bashki e Qark.
3. Vënia në dispozicion për njohje dhe zbatim, i akteve normative të Këshillit të Ministrave dhe Ministrive të linjës, për të gjitha Institucionet në qark, bashkive dhe këshillit të qarkut, me qëllim zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këto aktë për fushën e veprimtarisë që mbulojnë.
4. Drejtimi i veprimtarisë së strukturave administrative shtetërore, të cilat, me akte ligjore e nënligjore të veçanta, janë caktuar në varësinë e drejtpërdrejtë të titullarit të Institucionit të Prefektit.
5. Si i vetmi institucion administrativ që verifikon ligjshmërinë e akteve të miratuara nga organet e qeverisjes vendore, bashki e qark, në përputhje me dispozitat e kreut III të Ligjit për Prefektin, ushtron kontroll financiar mbi këto organe në mënyrën dhe limitet e përcaktuara me ligj.
6. Bashkëpunimi me organet e policisë të shtetit lidhur me marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në territorin e qarkut. Kërkon prej tyre zbatimin e përgjegjësive dhe detyrave duke bashkërenduar veprimtarinë e tyre me institucionet e tjera në qark dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore sipas përkatësisë.
7. Parandalimi dhe shmangia e pasojave që mund të vijnë nga situatat emergjente ose nga fatkeqësi natyrore në qark, duke plotësuar të gjitha detyrimet që i ngarkohen me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e mbrojtjes civile.
8. Ushtrimi i kontrollit në lidhje me funksionet dhe përgjegjësitë e deleguara nga pushteti qëndror, e në mënyrë të veçantë duke kërkuar përdorimin me efikasitet të fondeve që u delegohen institucioneve vendore ose Njësitë të Qeverisjes Vendore në Qark.

### 3: Veprimtaritë e institucionit:

Realizimi i objektivave dhe programit të Qeverisë Shqiptare në nivel vendor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në Qark, është kryer nëpërmjet zhvillimit të Komiteteve, Task-Forcave, ngritjes të grupeve të punës, takimeve me drejtues institucionesh, përfaqësues të Ministrive, korrespondencave zyrtare me institucionet përgjegjëse, takimeve e verifikimeve në vend, takime me biznese e personalitete të fushave të ndryshme etj.

Drejtimi i task-forcave, komiteteve dhe të komisioneve për çështje të caktuara:

- Përsa i përket detyrimeve ligjore lidhur me drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e Emergjencave Civile, janë zhvilluar takimet me Komisionin e Mbrojtjes Civile në shkallë qarku për menaxhimin e E.C Verore e Dimërore. Vëmendja kryesore e punës ka qenë zhvillimi i mëtejshëm i konceptit për mbrojtjen civile, evidentimi i rrezikut të risqeve, koordinimi i punës dhe marrja e masave parandaluese për zvogëlimin e efekteve dhe të pasojave të tyre negative si dhe menaxhimi sa më mirë i situatave problematike emergjente. Theks i veçantë i është kushtuar evidentimit të strukturave operacionale për mbrojtjen civile në nivel vendor, gjendjen dhe gatishmërinë e tyre, saktësimin e detyrave në rast situatash emergjente, njohjen në vazhdimësi me aktet ligjore e nënligjore dhe ato që dalin në veprimtarinë e përditëshme për MC dhe përballimin e situatave emergjente.
- Lidhur me kontrollin dhe monitorimin e politikave në fushën e turizmit si dhe në zbatim të përcaktimeve të Ligjit Nr.93/2015, datë 27.07.2015 “Për Turizmin”, Udhëzimit Nr.8502, datë 24.10.2016 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit” janë zhvilluar dy takimet e K.R.ZH.T-së në Pogradec e Korçë. Qarku i Korçës është kthyer në një nga destinacionet më të rëndësishme turistike, por edhe një nga sektorët më të rëndësishëm për ekonominë lokale që gjeneron të ardhura e punësim. Në vijim, në çdo takim e Komitet të zhvilluar është vënë theksi në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional si dhe zbatimin e përgjegjësive sipas fushave përkatëse, me qëllim shtimin e numrit të vizitorëve si dhe zhvillimin e këtij sektori për Qarkun e Korçës.
- Në zbatim të përcaktimeve të Ligjit Nr.81/2018 “Për Zonat e Mbrojtura” dhe VKM Nr.593, datë 09.10.2018 “Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore”, janë zhvilluar dy takimet e K.M.Z.M.M-ve “Parku Kombëtar i Prespës” dhe “Peisazhi i Mbrojtur Tokjësor, Ujor i Pogradecit”. Në Komitete është theksuar domosdoshmëria e hartimit të Planeve të Menaxhimit si dhe është kërkuar rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional e arritja e objektivave të përcaktuara në legjisllacionin shqiptar për Zonat e Mbrojtura, ndërjegjësimi i komunitetit për ruajtjen dhe shtimin e vlerave të Zonave të Mbrojtura si dhe hartimi i projekteve me impakt për Z.M-të, me qëllim shfrytëzimin më të mirë të potencialit turistik të tyre.
- Në mbështetje të Planit të Veprimit Kombëtar, që ka për bazë Strategjinë Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore, janë zhvilluar takimet e Komitetit Rajonal Antitrafik dhe tryezat teknike të tij, me qëllim rritjen e bashkëpunimit me të gjithë strukturat në luftën kundër trafikimit të njerëzve në gjithë Rajonin e Korçës.
- Janë zhvilluar 2 (dy) takime të Komitetit Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, me qëllim identifikimin dhe referimin e rasteve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm (individët apo grupet vulnerabël në rrezik radikalizmi apo të radikalizuar), ndjekjen e të gjitha veprimeve, masave dhe aktorëve (shtetërorë ose jo shtetërorë) të përfshirë në parandalimin e radikalizmit.

- Paketa e Sigurisë në Shkollë: Janë zhvilluar takime me drejtuesit e institucioneve përgjegjëse, ku janë diskutuar detyrat e çdo institucioni, duke filluar me përcaktimin e një harte të territoreve me një rreze 50 m rreth shkollave në çdo njësi administrative të bashkive, vendosjen e sinjalistikës rrugore pranë objekteve arsimore dhe kontrolli i vazhdueshëm për lëvizjen e mjeteve në atë perimetër, si dhe pajisjen me kamera apo mjete të tjera, siç mund të jenë ato të shuarjes së zjarrit, etj. Iu është kërkuar drejtuesve të institucioneve të koordinojnë punën dhe bashkëpunojnë me Policinë Bashkiake respektive për monitorimin e operatorëve ushqimorë brenda perimetrit të përcaktuar, e kushteve të higjienës, përdorimit të duhanit në shkollë, mosfrimit të pijeve alkoolike për të rinjtë nën moshën 18 vjeç, një ndërveprim më efikas me Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit dhe atij Kombëtar për ndërtimet pa leje apo në proces ndërtimi rreth këtij perimetri, si dhe një rol akoma më aktiv nga të gjithë në bashkëpunim me Oficerët e Sigurisë të Policisë, për parandalimin e kriminalitetit dhe fenomeneve me risk për fëmijët e të rinjtë, fenomene që nuk lidhen vetëm me përdorimin e substancave narkotike, por edhe me bullizmin apo krimin kibernetik në dëm të të miturve. Janë kryer 31 (tridhjetënjë) monitorime me grupe të përbashkëta pune në shkollë të bashkive të Qarkut, ku është vlerësuar zbatimi i masave të marra.

#### Verifikimi i ligjshmërisë së akteve:

Përsa i përket përcaktimit ligjor për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, informojme se për vitin 2024 kanë hyrë në total 377 akte me karakter normativ, nga të cilat 350 akte janë konfirmuar ligjërisht, 28 akte janë gjendur të pambështetura në ligj dhe 12 akte janë rishqyrtuar nga Këshillat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

#### Nga shqyrtimi çdo muaj i veprimtarisë së degëve territoriale që veprojnë në qark, në mënyrë të përmbledhur ka rezultuar si vijon:

*1. Drejtoria Vendore e Policisë:* Ka patur objektiv kryesor të punës së saj garantimin e zbatimit të ligjit, mbrojtjen e jetëve njerëzore dhe ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike. Gjatë vitit 2024 ka patur rezultate të mira në disa drejtime dhe janë shënuar rënie në shifrat e krimit dhe një zbulueshmëri e lartë e veprave penale.

Janë evidentuar dhe referuar gjithsej **1 786** vepra penale, zbuluar **1 701** ose **95 %** e tyre, me 2080 autorë, nga të cilët 624 arrestuar, 60 ndaluar, 1.342 ndjekur në gjendje të lirë dhe 53 shpallur në kërkim. Gjatë këtij viti janë evidentuar **134** vepra penale më pak se në vitin 2023.

Është kapur mbi 404 kg lëndë narkotike cannabis sativa dhe sasi e konsiderueshme kokaine e heroine. Janë konstatuar 5 raste të kultivimit të bimëve narkotike, të zbuluara: 1 rast në territorin e bashkisë Korçë (me 1 bimë të mbjellë në një kasolle të braktisur), 1 rast në fshatin Voskop (me 2 bimë të mbjella në tokë private), 1 rast në fshatin Jallë, Njësia Administrative Velçan, bashkia Pogradec (me 610 bimë të mbjella në zonë pyjore), 1 rast në vendin e quajtur “Uji i ftohtë” Njësia Administrative Velçan, bashkia Pogradec (me 128 bimë të mbjella në zonë pyjore) dhe 1 rast në fshatin Dushar, Njësia Administrative Moglicë, bashkia Maliq (me 3 bimë të mbjella në pyll). Janë arrestuar 4 persona dhe 1 i shpallur në kërkim. Janë ngritur 1602 grupe kontrolli, dhe janë ushtruar 20939 kontrolle të objekteve të ndryshme, si serra, depo e objekte të tjera, ish depo ushtarake e tunele, shtëpi të braktisura, stalla/stane, ambjente të hapura, ish parcela. Janë zhvilluar 45 takime sensibilizuese.

Kanë ndodhur gjithsej 60 aksidente (8 vdekur, 6 plagosur rëndë, 58 plagosur lehtë).

2. *Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit*: Gjatë vitit 2024 janë përpunuar 4 984 884 shtetas nga të cilët kanë hyrë 2 521 989 shtetas shqiptarë dhe të huaj dhe kanë dalë 2 462 895 shtetas shqiptarë dhe të huaj. Janë përpunuar 1 926 821 mjete shqiptare dhe të huaja, nga të cilat të hyra 970 061 mjete të huaja dhe shqiptare dhe të dala 956 760 mjete të huaja dhe shqiptare.

3. *Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore*: Gjatë vitit 2024 ka lidhur 4078 pensione duke ulur mesataren për lidhjen e pensionit në 18 ditë nga 45 ditë që përcaktohet në aktet ligjore. Çdo aplikim bëhet on-line dhe i'u është përgjigjur në kohë dhe me cilësi të gjithë aplikantëve.

4. *Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Korçë*: Evidentohet të dhënat si më poshtë:

- 2225 inspektime nga të cilat 1873 të programuara dhe 352 të pa programuara; 16 aktivitete janë pezulluar dhe 8 raste kanë ndryshuar aktivitetin; 135 paralajmërime dhe 32 vënie gjobash; 19 raste bllokim mallrash, 14 raste asgjësim produktesh dhe 7 raste ndërprerje aktiviteti; janë marrë 598 mostra dhe janë realizuar 1199 analiza.

Gjatë periudhës raportuese DRAKU ka evidentuar disa problematika përkatësisht:

- Problem në lidhje me infrastrukturën e realizimit të procesit të inspektimit, vështirësi në koordinimin e mjeteve të transportit.
- Mos rinovimi i dokumentacionit nga OBU (analizë uji, librezë shëndetsore, çertifikatë dezinfektimi), për këtë është marrë masa administrative “Paralajmërim” ndaj subjekteve.

5. *Qendra e Formimit Profesional Publik Korçë*: Gjatë vitit 2024 ka realizuar thujtë plotësisht indikatorët sasiorë dhe cilësorë të kartës së performancës për vitin 2024. Konkretisht:

- Numri i punëkërkuessve të papunë që ndjekin kurset e formimit profesional 127%; Numri i punëkërkuessve të papunë që ndjekin kursin e aftësive digjitale 107%; Romë/egjiptianë 95%; P.A.K 150%; Ndihmë ekonomike 300%; Numri i bizneseve partnere me DROFPP-të 115 %.

6. *Drejtoria Rajonale e Ekstensionit Bujqësor (AREB)*: Përgjatë 2024 AREB Korçë ka punuar duke patur parasysh edhe nevojat dhe problematikat e fermerëve, duke realizuar 47 699 vizita në QIB, 625 takime në grup, 297 demostrime, 61 ditë fushe, 9 149 fletëpalosje dhe 32 trajnime me specialistë. 23 389 fermerë kanë përfituar nga skema e naftës.

7. *Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor*: Risi për këtë vit ka qene leja e re e qarkullimit, e cila përmban elemente sigurie të lartë, duke eliminuar certifikatën e pronësisë dhe lejen ndërkombëtare të qarkullimit. Gjithashtu risi ka qenë dhe aplikimi për targa me përzgjedhje dhe me formate të reja, shërbim ky që ka çuar dhe në rritjen e të ardhurave. Gjatë vitit 2024 janë kryer 174 910 veprime dhe janë paguar 41 368 taksa për mjetet e përdorura. Janë pajisur me leje drejtimi automjeti 6 193 aplikantë dhe me leje qarkullimi të modelit të ri 12 869 mjete dhe 2 914 aplikantë kanë ndryshuar pronësinë. Janë kryer 25 897 kontrolle teknike për automjetet, duke zbatuar parametrat e qarkullimit të mjeteve për eliminimin e ndotjes si dhe sigurinë në rrugë të mjeteve.

8. *Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë*: Gjatë vitit 2024 puna e QTTB Korçë ka konsistuar në:

- Aplikimin e teknologjive bashkëkohore për rritjen e prodhimit në kulturën e mollës, evidentimi dhe ruajtjen e kultivarëve në pemtoren koleksion, ruajtjen e nënshartësive, përmirësim e teknologjive nëpërmjet kërkimit në fermë etj;



- Aplikimin e teknologjive bashkëkohore duke bërë të mundur identifikimin e kultivarëve më të përshtatshëm për prodhim të materialeve mbjellëse dhe kultivimin e kulturave bujqësore të patates, elbit, prodhimin e farave SSE, SE dhe Elitë për kulturat e grurit, elbit, si dhe shumëzimin e farës së patates, elbit distik dhe polistik vjeshtor;
- Përmirësimin racor, transferimin e teknologjive të përparuara dhe bashkëkohore në feramat blegtorale, në të gjitha hallkat e mbarështimit të bagëtive të imta dhe gjedhit të zonave kodrinore malore, të cilat ka çuar në rritjen e treguesve të prodhimit të qumështit, mishit dhe të efektivitetit ekonomiko-financiar në këto ferma blegtorale.

9. *Drejtoria Rajonale e Ujitjes dhe Kullimit Korçë: Ka realizuar detyrat si më poshtë:*

- Ujitje. Skemat ujitëse janë vënë në punë brenda afatit ligjor (2 skema në Korçë) të cilat kanë dhënë shërbimin e ujitjes në mënyrë korrekte gjatë gjithë periudhës. Kullimi. Në qarkun Korçë është realizuar ndërhyrje në 4 objekte me një volum pastrimi prej 174.800 m<sup>3</sup> dhe punimet janë mbyllur në masën 100%. Mbrojtje nga përmbytjet. Për vitin 2024 ka pasur gjithsej 5 investime, nga të cilat 3 mbrojtje lumore, ndërkohë në dy investime (rehabilitim kanale ujitëse) punimet e kryera janë në 80%, por brenda grafikut të aprovuar. Emergjencat. Qarku i Korçës është me volum pastrimi 149 330 m<sup>3</sup> (me gjatësi 17 545 ml), i cili është realizuar në masën 100%. Me këto ndërhyrje janë shmangur përmbytje të tokave të fermerëve, por dhe është ndihmuar në kullim sa më të shpejtë, në mënyrë që të mos pengohet puna e tyre. Hidrovoret dhe Digat. DUK Korçë ka në administrim 2 hidrovore, një në Tushemisht, Pogradec dhe një në Konezbalt, në Berat. Gjatë vitit 2024 është bërë riparimin total i një prej pompave të hidrovorit të Tushemishtit, si pasojë e një defekti. Hidrovoret kanë qenë në gadishmëri dhe nuk kanë paraqitur probleme. Në periudhën e verës, kur dhe puna e tyre është më e pakët, është planifikuar të kryhet remont për t'i pasur në gadishmëri për sezonin e dimrit. DUK Korçë ka në administrim dy diga, atë të Gjançit në Korçë dhe atë të Belesovës në Kuçovë, ku janë kryer kontrole periodike për sigurinë e tyre dhe nuk janë paraqitur problematika.

10. *Drejtoria Rajonale e I.SH.P.SH.Sh, Rajoni IV:* Kjo drejtori ka inspektuar 1191 subjekte ekonomike e private, ka vendosur 498 dënime administrative, janë evidentuar 430 punëmarrës informalë, 18 punëmarrës të aksidentuar në punë ku janë vendosur 4 gjoba dhe 13 paralajmërimë.

11. *Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror:* Numri i aplikimeve në skemën e ndihmës ekonomike është 2608, janë bërë verifikime në 7053 familje, janë shqyrtuar 604 ankesa zyrtare, numri i dosjeve të komisionuara nga Komisionet e vleresimit bio-psiko-social ka qënë 4132 ku kanë dalë përfitues 3690.

12. *Drejtoria Rajonale Arsimore Korçë:* Ka pajisur me tekste shkollore të reja falas dhe në përdorim të gjithë nxënësit e arsimit bazë (klasa I - IX) dhe nxënësit për të gjitha kategoritë në nevojë, është rritur numri i punonjësve të shërbimit psiko-social, lidhur me zhvillimin profesional janë trajnuar rreth 65% të mësuesve, janë evidentuar 32 nxënës ekselentë, në programin “Arte dhe Zeje” janë përfshirë 70 shkolla me rreth 4000 nxënës përfitues, janë përfshirë 34 shkolla të arsimit bazë në projektin e SMARTLAB me 835 nxënës të klasës së parë.

13. *Njvksht Devoll:* Ka realizuar aktivitete të ndryshme sensibilizuese referuar problematikave aktuale, ka kryer rreth 22 testime Covid ku kanë rezultuar 7 persona pozitiv dhe janë aplikuar 59 doza vaksine, u aplikuan rreth 2500 doza vaksinimi kundër gripit sezonal, janë kryer 9377 analiza fiziko-kimike dhe 3211 analiza bakterologjike, pranë kabinetit dentar janë kryer 1637 vizita, përqindja e vaksinimit për grupmoshat 0-14 vjeç është 98%, numri i vizitave të kryera në QSH 4739.

14. *Njvksht Pogradeç*: Ka realizuar 285 aktivitete të ndryshme sensibilizuese referuar problematikave aktuale, në kuadër të projektit "Kujdesi Shëndetësor në Banesë" janë realizuar 1657 vizita, nga shërbimi stomatologjik shtetëror janë kryer gjithsej 6317 vizita në fëmijë 0-18 vjeç dhe të rritur të kategorive invalidë e pensionistë, janë kryer gjithsej 4287 depistime në shkollat rurale dhe urbane, janë realizuar analizat e ujit dhe të ambulanteve në laborator, janë analizuar ujërat sipërfaqësore të liqenit dhe të pishinave, të cilat kanë rezultuar brenda normave të lejuara.

15. *Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale Korçë*: Ka realizuar rimbursim në masën 99% të planit, janë rimbursuar 15000 receta me "Fisha diabeti" për pensionistët dhe grupmoshat 0-25 vjeç, kontrolli mjekesor baze i kryer në 25 kabinete të instaluar në Qendrat Shëndetësore dhe të ambulancës lëvizëse është realizuar në masën 102.84 %, ka lidhur kontrata për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore me 4 Spitale të Rajonit, ka rilidhur kontratë me 34 farmaci, 4 agjenci farmaceutike, 1 farmaci pranë Spitalit Rajonal Korçë dhe 1 IEVP.

16. *Dega e doganës Kapshticë*: Gjatë 2024 janë realizuar të ardhura në masën 526.140 mijë lekë nga 550.000 lekë të planifikuar, me një realizim të planit 96%. Në total të ardhurat e vitit 2024 janë 6.129.490 mijë lekë ose realizim 102% të planit prej 6.020.000 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 ka një rritje të realizimit të të ardhurave me + 1.032.590 mijë lekë.

17. *Dega e doganës Korçë*: ka përpunuar 2 651 deklaratat doganore. Fluksi i mjeteve të ardhura për zhdoganim për vitin 2024 ka qenë më i lartë se mjetet e ardhura të njëjtën periudhë 2023 me rreth 2%. Realizimi i të ardhurave për vitin 2024 ka qenë në vlerën 698 990 mijë lekë ose 104% krahasuar me planin vjetor. Totali i arkëtimeve të detyrimit të akcizës për periudhën Janar – Dhjetor 2024 është 295 387 877 lekë. Në 2024 janë marrë 15 vendime për shkelje doganore, shkelje akcize dhe rivlerësime, 14 vendime janë likuiduar plotësisht në shumën 100 %.

18. *Dega e Thesarit Korçë*: Ka realizuar objektivat e saj në zbatim të legjislacionit specifik në fuqi për Sistemin e Thesarit në Republikën e Shqipërisë. Nuk janë hasur problematika gjatë ushtrimit të veprimtarisë për vitin 2024. Ka pasur probleme teknike lidhur me mosfunksionimin e sistemit AFMIS, por ato janë zgjidhur në kohë në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të Ministrisë së Financave.

19. *Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore*: Gjatë vitit ka vazhduar financimi i projekteve të ndryshme të financuara nga buxheti i shtetit dhe financime nga fondet IPA, donatorë të ndryshëm, bashkëpunim me institucione të ndryshme, etj. Ka vazhduar monitorimi dhe inspektimi në terren i kësaj veprimtarie për një realizim sa më të mirë të projekteve.

20. *Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Dega Rajonale Korçë*: Gjatë vitit 2024 është ndërhyrë në rrjetin shpërndarës dhe janë realizuar remontet e mesme dhe profilaktike në kabina, linja TM, TU. Janë kryer kontrole periodike dhe janë marrë masat për mbajtjen e tyre në parametra nominale. Është bërë pastrimi i traseve të linjave, drejtime të shtyllave TM, zëvendësime, riparime ndarësash TM, prerje pemësh, tërheqje përcjellësash, pastrime, matje dhe simetrizim i ngarkesave të transformatorëve, zëvendësimi i pajisjeve të amortizuara, rrethimi i kabinave etj. Janë konstatuar pikat e dobëta në rrjet dhe janë marrë masat përkatëse. Në kabina janë realizuar 51 remonte të mesme dhe 384 remonte profilaktike, 65.45 km remonte të mesme në LTM ajrore dhe 284.85 km remonte profilaktike, 40.3 km remonte të mesme në LTU ajrore dhe 163.6 km remonte profilaktike. Gjatë vitit 2024 u krye azhurnimi i saktë i rrjetit shpërndarës TM në të gjithë rajonin e Korçës. Është ndjekur hap pas hapi lëvizja e transformatorëve dhe gjendjes së tyre në rrjet. Ka patur 32 raste në total

të djegies së transformatorëve, në të gjithë rajonin. Përgjatë vitit u hartuan 22 projekte për linjat TU ABC për ato fidera ku kishte humbje të mëdha, të cilat janë në fazë zhvillimi.

21. *NJVKSH Kolonjë*: Gjatë vitit 2024 ka kryer detyrat si më poshte:

- Monitorimi i sistemit alert; Kontrolli i ujit të pijshëm në Ersekë, Leskovik dhe fshatrat përreth; Kryerja e analizave në laboratorin mikrobiologjik (ambulate dhe spitalore); Vaksinimi i fëmijëve 0-18 vjeç; Vaksinim kundër Covid-19 dhe gripit stinor; Realizimi i mamografive falas për 120 gra; Shpërndarja dhe kryerja e PaP test; Shërbim, vizita dhe trajtim në kabinetin e stomatologjisë për fëmijët 3-18 vjeç dhe familjet me probleme social-ekonomike.

22. *Shkolla Profesionale Teknike, Korçë*: Kjo shkollë është krijuar si rezultat i bashkimit të tre shkollave profesionale shkolla e mekanikës, e ndërtimit dhe e teknologji-informacion-komunikimit, në kuadër të procesit të optimizimit, një proces i nisur nga AKFPA në linjë me Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Është ndërtuar një plan organizimi i rrjetit të gjithë ofruesve të arsimit profesional, duke marrë parasysh përputhjen e ofertës dhe kërkesës së gjithë rajonit. Kjo shkollë ju ofron nxënësve një kulturë dhe formim bashkëkohor në drejtimit mësimor: mekanikë, shërbime mjetesh transporti, elektronikë, ndërtim, termohidraulikë, TIK. Godina, ambienti, kabinetët dhe laboratorët, stafi drejtues, mësimor dhe mbështetës, ofrojnë dhe sigurojnë një zhvillim cilësor të mësimit praktik dhe teorik. Në këtë shkollë ka 480 nxënës gjithsej nga të cilët 35 vajza dhe 445 djem. Ka bashkëpunim të rëndësishëm me sektorin privat në rajon, i cili ofron mundësi për kryerjen e praktikave profesionale dhe për punësim.

23. *Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat, Elbasan, Korçë*: Nga Sektori i Inspektimit Mjedisor janë kryer 299 inspektime/proçes-verifikime, si dhe janë trajtuar mbi 40 ankesa dhe 8 (tetë) çështje të ardhura nga Portali i Bashkëqeverisjes dhe janë vendosur 12 masa administrative. Nga Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërat) janë kryer 70 inspektime, janë vendosur 3 gjoba në vlerë 3.030 mijë lekë, 6 dënime me paralajmërim dhe 1 pezullim e mbyllje aktiviteti. Nga Sektori i Lejeve Mjedisore janë dhënë gjithsej 195 mendime për VNM të Thelluar dhe VNM Paraprake, janë dhënë mendime për leje mjedisore për 95 subjekte si dhe janë zhvilluar 53 konsultime me publikun, për subjekte dhe aktivitete të ndryshme.

24. *Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria Rajonale Korçë*

Nga Sektori i Inspektimit të Kontrollit të Territorit janë kryer 151 inspektime dhe janë konstatuar 18 shkelje.

Nga Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave janë kryer 397 inspektime dhe janë konstatuar 13 shkelje.

Nga Sektori Pyjor janë kryer 446 inspektime dhe nuk janë konstatuar shkelje.

25. *Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Korçë*: Menaxhimi: AdZM ka pranuar kërkesat e çdo subjekti që kërkon të ushtrojë aktivitet në territorin e ZMM dhe për vitin 2024 AdZM ka pasur 13 kontrata aktive dhe janë lidhur 6 kontrata të reja. Monitorimi: Janë kryer 661 monitorime për aktivitet të paligjshëm, 541 monitorime të faunës së egër dhe ndërhyrje përmirësuese në 30 ha në të gjithë Zonat Mjedisore të Qarkut dhe në Parkun Kombëtar të Prespës. Janë evidentuar 11 raste të aktiviteteve të jashtëligjshme në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe sektorët e pyjeve në Bashkitë e Qarkut. Ka pasur 5 raste zjarresh në PMTU “Liçeni i Pogradecit” dhe Parkun Kombëtar “Prespa” në një sipërfaqe totale prej 3275.6 ha. Si rezultat i bashkëpunimit të shpejtë dhe efikas midis institucioneve është bërë i mundur izolimi i tyre brenda një kohe të shkurtër duke minimizuar dëmet.

26. *Drejtoria e Rajonit Qendër-Lindje Korçë*: Akset rrugore në administrim të Drejtorisë së Rajonit Qendër Lindje Korçë, mirëmbahen me programin Rutinë + Dimërore nga ana e Kontraktorëve Privatë. Është punuar gjatë gjithë vitit

2024 në mirëmbajtjen rutinë kryesisht: Mirëmbajtje dimërore nga 1 Janari 2024 deri në 15 Mars 2024, dhe nga 15 Nëntor 2024 deri në 31 Dhjetor 2024 në pastrimin e akseve rrugore në administrim nga dëborë me anë të kontraktorëve të mbikqyrur nga ana e Drejtorisë, është bërë largimi i dëborës nga karexhata e rrugës, janë kriposur të gjitha akset në kohë me dëborë dhe me ngrica. Gjatë gjithë vitit është punuar me sinjalistikën rrugore në të gjitha akset në administrim, me zëvendësim sinjalistike të dëmtuar ose vendosje sinjalistike ku mungon.

27. *Inspektorati Shtetëror Shëndetësor*: Gjatë vitit 2024 ka kryer gjithësej 1516 inspektime, nga te cilat 1371 inspektime brenda programit dhe 142 inspektime jashtë programit; Janë pajisur me akt-miratim higjieno-sanitar 107 subjekte; Janë monitoruar për zbatimin e ligjit antiduhan 3353 subjekte; Janë vendosur 16 masa administrative: 12 masa administrative gjore, 2 paralajmërime, 2 vendime të ndermjetem të masës urgjente.

#### Monitorimi i zbatimit, në nivel qarku, të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave:

a) Janë kryer 10 (dhjetë) inspektime në investimet kryesore në Qark, si më poshtë vijon:

1. Rikonstruksioni i shkollës “Sevasti Qiriazii” në Korçë, një investim i qeverisë shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në masën 80% (me vlerë 56,993 milionë lekë të rinj) dhe bashkëfinansim në masën 20% nga Bashkia Korçë (me vlerë 14,248 milionë lekë të rinj).
2. Rikonstruksioni i shkollës “Ymer Dishnica” në Korçë, një investim i qeverisë shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në masën 80% (me vlerë 75.000 milionë lekë të rinj) dhe bashkëfinansim në masën 20% nga Bashkia Korçë (me vlerë 18.750 milionë lekë të rinj).
3. Rikonstruksioni i aksit rrugor Maliq-Lozhan i Ri-Strelcë. Rruga ka gjatësi 20 km e gjerësi 8 m dhe po realizohet me financim të qeverisë në vlerën 1.397.257 lekë me tvsh.
4. Projektet në Pogradec me financim të Fondit Shqiptar të Zhvillimit me vlerë 499,163,991.40 lekë me TVSH, ku po vazhdon puna e ndërtimit të shëtitores së Tushemishtit, ndërkohë që segmenti rrugor Tushemisht - Doganë ka përfunduar.
5. Dy segmente rrugore rurale të zonës së Mokrës, me gjatësi totale 19,2 km. Segmenti që fillon nga fshati Slabinjë deri në fshatin Bishnicë (12 km) është i financuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit me vlerë 91 830 356 lekë pa tvsh nga programi "Rrugët e Bardha". Segmenti Ura e Zëmçës - Proptisht deri në fshatin Slabinjë (7,2 km), ku punimet janë financuar nga Bashkia Pogradec me vlerë 184 651 769 lekë pa tvsh dhe përfshin rehabilitimin e rrugës, vepra arti, asfaltim, rehabilitim të qendrave të fshatrave Slabinjë dhe Proptisht.
6. Shkolla 9-vjeçare "Myredin Bashalli" në Lin. Një investim 59 385 263,66 lekë me TVSH i qeverisë (80%) dhe me bashkëfinansim të Bashkisë së Pogradecit (20%).
7. "Ndërtimi i rrugës Pogradec-Tushemisht-Doganë Loti 2", që përshkon edhe unazën e fshatit Tushemisht nga burimet e Zagorçanit, i financuar nga Qeveria dhe Banka Botërore nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit me vlerë afërsisht 3.5 milionë \$ me tvsh.
8. Realizimi i rikonstruksionit të segmentit Arrëz-Nikolicë me gjatësi 4.2 km dhe vlerë kontrate 50,827,590 lekë me TVSH.
9. Projekti i ndërhyrjeve rigjeneruese në blloqet e banimit në Leskovik, financuar nga qeveria nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit me vlerë investimi 32,130,078 lekë me TVSH.
10. Segmenti Sinicë-Dardhë me një gjatësi 5 km, një investim i qeverisë me vlerë financimi 73,067,014 leke me tvsh.

b) Janë zhvilluar 57 takime me drejtues institucionesh, kryetarë bashkie dhe administratorë ku janë diskutuar problematikat e rezultuara në çdo institucion gjatë veprimtarisë së tij, janë trajtuar masat për emergjencat civile, sensibilizimi për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale për kultivimin e bimëve narkotike, prerjes së pyjeve, si dhe organizimin e strukturave të grupeve të vullnetarëve dhe përgatitjen e tyre për gatishmëri në raste të emergjencave, zhvillimi i qëndrueshëm urban, problematikat në bujqësi (skemat e subvencionimit të naftës e produkteve të tjera), përdorimi, hedhja në treg, prodhimi, importimi apo futja në territor e qeseve plastike të degradueshme, promovimi i turizmit në Rajonin e Korçës, problematikat në shëndetësi, problematikat në arsim (gjendjen e infrastrukturës shkollore, kopshteve e çerdheve (në qytet e në fshat), detyrimet e plotësuara nga NJVV-të para fillimit të sezonit të ri shkollor, nevojat për mirëmbajtje e pajisje, sigurimin e ngrohjes së institucioneve arsimore për periudhën e dimrit, masat për furnizimin me tekste e materiale shkollore, nivelin e dixhitalizimit në shkollat e qarkut), problematikat e furnizimit me energjë elektrike etj.

#### Pjesëmarrja në ceremonitë zyrtare shtetërore që zhvillohen në nivel qarku:

64 aktivitete të ndryshme, të organizuara nga institucioni i Prefektit ose në të cilat është marrë pjesë. Këtu përfshihet pjesëmarrja e Prefektit të Qarkut dhe nënprefektëve në ceremonitë që zhvillohen me rastin e festave kombëtare, festave fetare, konferencave shkencore, promovimit të personaliteteve të ndryshme, panaire, ceremoni përkujtimore, organizime nëpër shkolla të qarkut, dhënie tituj nderi, organizime sportive, aktivitete me tematika të ndryshme, promovime librash, organizime kulturore etj.

#### Takime me bizneset që operojnë në Qarkun e Korçës:

Janë zhvilluar 22 takime në bizneset e ndryshme që ushtrojnë veprimtarinë në qarkun e Korçës, të cilat kanë përfutur subvencione nga Qeveria Shqiptare nëpërmjet projekteve të ndryshme në fushën e bujqësisë. Takimet kanë pasur në fokus informimin mbi ecurinë e aktivitetit dhe problematikat e hasura. Objekt i veprimtarisë të bizneseve kanë qenë kryesisht bujtina të ndërtuara rishtazi, ferma të reja por dhe tregëtim bimësh aromatiko-mjekësore, prodhim vere, tregëti xhami etj. Veprimtaria e këtyre subjekteve është promovuar në median sociale të institucionit, si një vlerë e shtuar e qarkut.

#### Takime në zyrë me personalitete të njohur:

Janë zhvilluar 27 takime me persona të cilët kanë dhënë një kontribut të veçantë për Qarkun e Korçës në fusha të ndryshme dhe kanë pasur ndikim në zhvillimin e mëtejshëm të tij. Në këto takime janë shkëmbyer ide e opinione mbi çështje të ndryshme që ndodhin në qark e më gjerë. Ata duhet të jenë gjithmonë aktivë e prezentë në përpjekjet dhe nismat që ndërmerren nga institucione e organizma të ndryshme, të cilat kanë fokus përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe solidaritetit profesional në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të gjithë rajonit të Korçës.

#### Komiteti Pilotues për çeljen e Liceut Francez:

Përgjatë vitit 2024 u realizua krijimi dhe zhvillimi i 2 (dy) takimeve të Komitetit Pilotues për bashkëpunim mes institucioneve qëndrore e vendore me ekspertin e qeverisë franceze, z. Jérôme Lebars, që tashmë është i atashuar në

institucionin e Prefekturës, për të punuar lidhur me projektin e çeljes së Liceut Francez në Korçë, një kërkesë e Kryeministrit Rama që u mirëprit nga Presidenti Macron, në vizitën e tij në vendin tonë.

Ky projekt është vazhde e traditës së miqësisë më të mirë mes dy vendeve tona dhe do të zgjerojë hapësirën për një perspektivë të re për shumë të rinj të qarkut tonë e më gjerë, të cilët në të ardhmen mund të zgjedhin këtë shkollë për arsimin e tyre të mesëm, duke i krijuar vetes mundësinë edhe për studime universitare në Francë.

#### Të tjera:

1. Në zbatim të Urdhërit nr.120 datë 17.7.2024 të Kryeministrit “Për një ndryshim në Urdhërin nr.9 datë 12.01.2016 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institucionit të Prefektit të Qarkut të Korçës”, me kerkese nr.716 prot, datë 06.08.2024 "Kërkesë për ngritjen e komisionit të ristrukturimit" te Sekretarit të Pergjithshëm drejtuar D.A.P-it, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit me Urdhër Nr.535, date 15.08.2024 të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike. Komisioni i Ristrukturimit, pasi mori në shqyrtim strukturën dhe organikën ekzistuese si dhe organikën e re te Administratës të Prefektit të Qarkut Korçe, si dhe vlerësoi mundësitë e transferimit të perhershëm të secilit prej nëpunësve, në datën 06.09.2024, dërgoi aktet e transferimit për shkak të ristrukturimit të institucionit, për secilin nga nëpunësit e Prefekturës Korçë.

2. Përgjatë vitit 2024, në institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë, u krye një kontroll dy-mujor nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën 01.01.2022 – 01.12.2023, me objekt “Auditimi i Përputhshmërisë së Veprimtarisë së Subjektit Prefektura Korçë”, lidhur me zbatimin e ligjeve, vendimeve, rregullave, rregulloreve dhe politikave gjatë verifikimit të përputhshmërisë së akteve të miratuara nga organet e Vetëqeverisjes Vendore në qarkun e Korçës. Në përfundim të auditimit, institucioni i Prefektit u njoh me projekt-raportin dhe raportin përfundimtar të audituesve të KLSH. Pas leximit të këtyre raporteve, institucioni ezauroi të drejtën e paraqitjes së kundërshtimeve për disa çështje, për të cilat qëndrimi ynë institucional ishte i ndryshëm nga ai i audituesve të KLSH.

Pas përfundimit të kësaj faze, në raportin përfundimtar, KLSH rekomandoi marrjen e masave organizative për rregullimin e disa çështjeve që lidhen me veprimtarinë e institucionit, me qëllim përmirësimin e praktikave të punës. Gjithashtu, KLSH rekomandoi fillimin e ecurisë disiplinore për 11 nëpunës të institucionit. Pas vlerësimit ligjor të këtij rekomandimi, u morën të gjitha masat për zbatimin e detyrimit ligjor, duke ngritur një Komision Disiplinor për shqyrtimin e rekomandimeve të KLSH dhe kundërshtimeve të paraqitura nga nëpunësit, lidhur me ecurinë disiplinore. Në përfundim, Komisioni Disiplinor, pas shqyrtimit të provave, rrethanave dhe fakteve ligjore, nxorri vendimet përkatëse, duke rrëzuar rekomandimet e KLSH për fillimin e ecurisë disiplinore për 11 nëpunës. Institucioni ka informuar zyrtarisht KLSH për vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor.

Sa i përket zbatimit të masave organizative të rekomanduara nga KLSH, institucioni ynë ka zhvilluar takime me përfaqësues të NJVV-ve në qark, duke kërkuar përmirësimin dhe unifikimin e praktikave të punës, sa i përket verifikimit të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ.

#### 4: Nënprefektura Pogradec:

Viti 2024, synoi në thellimin e mëtejshëm të koordinimit të punës midis institucioneve me qëllim realizimin e masave dhe të detyrave të planifikuara në funksion të misionit dhe të detyrave të institucionit të Prefektit. Në këtë kuadër realizimi i detyrave nga ana jonë vazhdoi, duke thelluar më tej bashkëpunimin me institucionet dhe qeverisjen vendore.

Në funksion të këtij objekti, misionit e detyrave u fokusua veprimtaria jonë, ku disa nga drejtimet kryesore të punës kanë qënë:

- Realizimi i detyrave të planifikuara dhe ato të deleguara nga Institucioni i Prefektit dhe institucionet e tjera qëndrore dhe në nivel vendor.
- Bashkërendimi i punës dhe marrja e masave për mbrojtjen civile, përballimin e emergjencave civile dimërore dhe verore.
- Bashkërendimi i punës me bashkinë, institucionet shtetërore në nivel vendor për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje, kullota, objekte, shtëpi banimi, etj.
- Pjesëmarrja në takime e tryeza pune, bashkëpunimi me bashkinë, shoqata të ndryshme në funksion të menaxhimit dhe promovimit më të mirë të turizmit në përgjithësi dhe vlerave historike, kulturore dhe natyrore në veçanti.
- Organizimi i punës dhe bashkërendimi i veprimtarive për parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore, në veçanti të grave e fëmijëve, dhunës në familje, evidentimin e familjeve me probleme të ndryshme ekonomike e sociale etj.
- Njohja, evidentimi i kërkesave dhe ankesave të bëra nga banorë të ndryshëm dhe ato të deleguara dhe bashkërendimi i punës për zgjidhjen e tyre.

##### 1. Puna e bërë për pastrimin dhe higjienizimin e territorit.

Bashkërendimi i punës për pastrimin dhe higjienizimin e territorit, ka qënë prioriteti kryesor i punës sonë. Është punuar për realizimin e detyrave të deleguara nga institucioni i Prefektit dhe institucionet e tjera shtetërore, lidhur me zbatimin e detyrimeve të përbashkëta në funksion të marrjes së masave për pastrimin dhe higjienizimin e territorit. Bashkërendimi i punës ndërmjet bashkisë dhe institucioneve shtetërore në nivel vendor për të mbajtur një territor të pastër ja ka arritur qëllimit.

Një problem i cili nuk po merr zgjidhje është largimi i mineraleve nga depozitimi në Gurin e Kuq. Në bashkëpunim me Albminierën është kërkuar nga bashkia vënia në dispozicion në Çervenakë të një vend depozitimi.

Ka vazhduar sensibilizimi i qytetarëve për ruajtjen dhe higjienizimin e ambientit.

Në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore dhe Drejtorinë e Shëndetit Publik janë zhvilluar takime në shkolla të ndryshme të bashkisë për sensibilizimin e nxënësve.

##### 2. Organizimi i punës dhe marrja e masave në funksion të mbrojtjes civile për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, ka qënë prioriteti kryesor i punës sonë.

- Janë marrë takime e kontakte të vazhdueshme me komisionin MC në Prefekturë dhe në bashki, si dhe janë kryer investigime dhe bashkëpunime të veçanta dhe të përbashkëta për problemet dhe situatat dimërore e verore të krijuara.
- Kemi bashkëpunuar në drejtim të evidentimit të problemeve e rreziqeve që përbëjnë shqetësim për jetën dhe veprimtarinë e përditshme të komunitetit duke synuar në minimizimin e efekteve të tyre negative.
- Kemi kërkuar nga Sektori i Emergjencës Civile në bashki që t'iu japë zgjidhje problemeve të ndodhura si shkak i fatkeqësive të ndryshme.

- Shlyerja e një pjese të vlerës së dëmeve të ndodhura si rrjedhojë e fatkeqësive natyrore të rreth 60 familjeve të mbetura ndër vite nga Agjencia e Kombëtare e Emergjencave Civile.

Me gjithë punën e bërë dhe masat e realizuara në funksion të MC të popullatës, përsëri janë evidentuar probleme e vështirësi si më poshtë:

- Në disa akse rurale si: Trebinjë-Llëngë, Bishnicë-Jollë, Proptisht-Laktesh-Senisht, Katjel-Rrodokal-Homezh, Dardhas-Sterkanj etj., janë bërë ndërhyrje nga ana e bashkisë por për shkak të amortizimit ka vështirësi në mirëmbajtjen e tyre sidomos gjatë stinës së dimrit.
- Probleme në kanalin e kullimit, në rrugën nacionale Baçallëk-Pogradec. Është kërkuar vazhdimisht për ti dhënë zgjidhje.
- Dëmtimi dhe amortizimi i ish objekteve apo pronave shtetërore të cilat përbëjnë rrezik për jetën e komunitetit (Objektet e ish-minierës në Potkozhan, Guri i Kuq kërkojnë ndërhyrje urgjente).
- Ofrimi i ndihmës për familjet në nevojë, për ndërhyrje në disa ndërtesa (shtëpi banimi) në zonat rurale që janë shumë të amortizuara, kryesisht dëmtime në tavane dhe çarje në mure. Nga ana e bashkisë është ndërhyrë në një pjesë prej tyre në veçanti në njësitë administrative Velçan dhe Trebinje.
- Probleme me furnizimin me energji elektrike të disa fshatrave në njësitë administrative Proptisht dhe Velçan, nga nënstacioni i Prrenjasit dhe Dardhas nga nënstacioni i Maliqit, (Ndërprerje e vazhdueshme dhe reagimi me vonesë nga ana e punonjësve të OSHE-së etj.) Është kërkuar vazhdimisht ndërhyrje në takimet e zhvilluara me OSHE-në.

Në kuadrin e MC të popullatës gjatë stinës së verës vëmendja kryesore është përqëndruar në drejtim të masave për mbrojtjen nga zjarri duke menaxhuar sa më mirë situatat e krijuara, janë evidentuar 193 ndërhyrje operacionale, nga të cilat 134 raste ndërhyrje operacionale për zjarret dhe 59 raste ndërhyrje operacionale për shpëtim:

- 32 raste në objekte dhe shtëpi banimi;
- 3 raste në aktivitete të ndryshme kryesisht në bazë ushqimore për bagëti, magazina etj.
- 19 raste në mjete transporti;
- 80 raste në pyje, kullota, shkurre e mbetje të ndryshme;
- 59 raste shpëtimi (të ndryshme).

Ka një angazhim të mirë të personelit të shërbimit të MZSH-së, ndërgjegjësim të komunitetit dhe bashkëpunim me qeverisjen vendore lidhur me parandalimin dhe reagimin në kohë ndaj këtyre fenomeneve.

Për shërbimin e MZSH-së vazhdon të mbetet shqetësim dhe domosdoshmëri blerja e një automjeti për zonat malore. Ndërtimet e bëra pa kriter vështirësojnë ndërhyrjen e mjeteve të MZSH-së në zonat urbane e rurale.

Është në proces pune ndërtimi i stacionit të ri të MZSH-së, pasi ambientet aktuale janë në gjëndje shumë të keqe.

3. Gjatë këtij viti janë organizuar takime e diskutime të përbashkëta pune me drejtuesit e institucioneve shtetërore në nivel vendor, qeverisjen vendore dhe shoqërinë civile lidhur me:

- Përmbylljen e detyrimeve të caktuara në zbatim të programit të Qeverisë Shqiptare në ushtrimin e funksioneve dhe zbatimin e kompetencave për rritjen e performancës, angazhimin dhe përkushtimin në realizimin e detyrave institucionale dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.
- Për problemet e trafikimit të qënieve njerëzore, dhunën ndaj grave etj.



Në kuadrin e bashkëpunimit dhe realizimit të detyrimeve të përbashkëta, marrëdhëniet institucionale kanë qënë në një nivel të mirë, për rrjedhojë:

- Është rritur niveli i drejtimit të institucioneve shtetërore dhe vazhdon puna për konsolidimin e tyre, ka angazhim dhe përkushtim në realizimin e objektivave dhe të detyrave.
- Është thelluar puna për goditjen e fenomeneve negative dhe informalitetit etj.
- Është rritur cilësia e shërbimeve ndaj komunitetit, në veçanti me hapjen e portalit qeveritar e-albania.
- Janë evidentuar tregues të mirë ekonomiko-shoqërorë etj, ku mund të përmendim:

Janë organizuar takime me institucione përgjegjëse lidhur me sigurinë publike, trafikimin e qënieve njerëzore. Marrja e masave për parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore dhe të fëmijëve, dhunës në familje, evidentimin e familjeve me probleme të ndryshme ekonomike e sociale.

Është ndërmarrë një fushatë sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, si dhe në institucione të ndryshme, për t'i thënë “STOP” dhunës në familje dhe për të parandaluar këto probleme negative.

Është bashkëpunuar me bashkinë, fondacione, organizata dhe shoqata të ndryshme, për të minimizuar efektet negative të këtij fenomeni dhe për t'u ardhur në ndihmë familjeve në nevojë.

Edhe në këtë drejtim kërkohet më shumë bashkëpunim institucional.

#### 4. Shërbimet ndaj komunitetit.

Zyra e Gjendjes Civile Arkivi Pogradec dhe Zyrat e Gjendjeve Civile në bashki dhe njësitë administrative kanë synuar në rritjen e performancës dhe cilësinë e shërbimeve, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve komunitetit për probleme të ndryshme. Është unifikuar dokumentacioni dhe u janë dhënë zgjidhje shumë kërkesave e ankesave që lidhen me zyrat e Gjendjes Civile, duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe institucionet e tjera respektive. Dokumentat që lëshon Zyra e Arkivës së Gjendjes Civile, plotësohen në formatin elektronik në përputhje me programin e Arkivit. Është punuar në vazhdimësi dhe janë pasqyruar në kohë të dhënat në Regjistrin Elektronik Kombëtar.

#### Permbledhje 2024

Fokusi i punës tonë ka qënë përballimi me sukses i emergjencave dimërore dhe verore. Janë zhvilluar takime me institucionet qendrore në nivel vendor, me kompaninë 2T për mirëmbajtjen e rrugëve nacionale, me bashkinë për mirëmbajtjen e rrugëve rurale, me OSHE -në për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik dhe riparimin e defekteve të krijuara.

Janë zhvilluar takime me sektorin zjarfikës pranë bashkisë Pogradec, takime sensibilizuese me bashkinë dhe njësitë vendore për parandalimin e zjarreve dhe gatishmërinë në rast rënie zjarri. Janë zhvilluar takime sensibilizuese për parandalimin e prerjes së pyjeve dhe evidentimin e parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike.

Janë marrë masat e duhura për menaxhimin e sezonit turistik me angazhimin e strukturave të bashkisë, policisë, shëndetit publik dhe spitalor, OSHE etj, Viti 2024 ka patur tregues më të mirë se viti i kaluar. Numri i vizitorëve për vitin 2024 është rreth 20% më shumë se viti 2023. Nje pune shumë e mirë është bërë për pastrimin dhe higjienizimin e territorit të bashkisë.

Gjatë takimeve dhe komunikimeve me të gjitha institucionet e bashkisë Pogradec, janë trajtuar problemet e shëndetit, arsimit, rendit dhe sigurisë publike, bujqësisë, pronave, turizmit, higjienizimit, energjisë, punësimit dhe problemeve sociale.

Për problemet që kanë shqetësuar banorët, kemi organizuar takime me fshatrat Lin, Buqezë, Memlisht, Derdushë, Nicë, Dardhas, Grunjas, Blacë, Nizhavec, Petrushë, Dunicë, Pleshisht, Kalivaç, Hondisht, Homezh, Slabinjë, Kriçkovë, Losnik, Velçan, Bishnicë, Rëmenj, Tushemisht, Guras etj.

Jemi takuar me 158 banorë për probleme të ndryshme si ato të pronës, probleme sociale, arsimore etj. të cilat janë trajtuar dhe orientuar sipas institucioneve përkatëse.

Janë zhvilluar takime me shoqata dhe fondacione të ndryshme, që veprojnë në territorin e bashkisë, lidhur me punën dhe problematikat e tyre si dhe u kemi shprehur falenderime për ndihmën e ofruar familjeve në nevojë.

-Disa nga problematikat e konstatuara:

- Problemi i rrugëve rurale në zonën e Mokrës dhe të Gorës.
- Problemi i energji elektrike në njësitë administrative Dardhas dhe Proptisht.
- Transferimi i mbetjeve minerale nga dampa në Gurin e Kuq.
- Shpronësimet në unazën e qytetit.
- Likuidimi i familjeve që ju kanë ndodhur fatkeqësi natyrore.
- Problemi i librave të trojeve të disa fshatrave, vonesat në marrjen e certifikatave të pronësisë, problemet e tokave bujqësore në Kalivaç, Proptisht, Piskupat.
- Çmimi i lartë i imputeve bujqësore, ndërhyrje në rrugët e parcelave, problemi i vaditjes.
- Vazhdimi i fazës së dytë të 20 kë.
- Zhvendosja e dokumentacionit të Nënprefekturës, prane arkivës së Prefekturës.

#### **IV: Nënprefektura Kolonjë:**

Gjatë vitit 2024 fokusi kryesor i punës i Nën/Prefektit të Kolonjës ka qenë realizimi i objektivave të vëna në fillim të vitit të cilat konsistojnë në ndjekjen dhe menaxhimin e situatave të krijuara në stinën e dimrit dhe atë të verës, problemeve të koordinimit të punës me institucionet qendrore vendore, bashkëpunimin dhe bashkërendimin e problematikave dhe aktiviteteve me pushtetin lokal si dhe evidentimin e problematikave të paraqitura dhe zgjidhjen e tyre.

Janë ndjekur me përparësi Vendimet e Udhëzimet e nxjerra nga Qeveria si dhe Vendimet e Udhëzimet e Institucionit të Prefektit të Qarkut, lidhur me situatën e krijuar në të gjitha fushat e aktivitetet dhe veprimtaritë ekonomiko-financiare.

Koordinimi i punës me institucionet shtetërore në nivel vendor për realizimin e detyrimeve dhe të angazhimeve të përbashkëta në kuadrin e integritit në strukturat Evropiane dhe të reformimit të strukturave të qeverisjes vendore mbështetur në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

1. Gjatë gjithë vitit u punua në drejtim të evidentimit dhe njohjes në dinamikë të të gjitha akteve ligjore e nënligjore për funksionimin e institucionit të Nënprefekturës.
2. Mbatëm një komunikim të vazhdueshëm me strukturat e institucioneve që ushtrojnë aktivitetet në territorin e bashkisë Kolonjë, me Bashkinë Kolonjë dhe drejtoritë në varësi të saj, Komisarjati i Policisë, Shëndetësia, Arsimi, Drejtorinë Vendore të Kadastrës, OSHEE, Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore si dhe rrjetet e shërbimit të qytetarëve. Bashkëpunimi me këto institucione ka qenë i mirë dhe ka ndikuar në zgjidhjen sa më të shpejtë të problematikave të krijuara, sidomos në drejtim të dhënies përgjigje të kërkesave tona për transparencën dhe mënyrën e administrimit të

investimeve të Qeverisë në të gjitha institucionet vendore e sidomos me Bashkinë Kolonjë, lidhur me procedurat ligjore mbi të cilat hartohen e ekzekutohen Vendimet e Këshillit bashkiak gjithmonë në interesin publik.

3. Kemi qenë prezente në të gjitha takimet e diskutime për problemet e ecuresisë për zhvillimin ekonomik-shoqëror të bashkisë zhvillimin e turizmit dhe shfrytëzimin e resurseve e kapaciteteve që ofron kjo treve në përmirësimin e mirëqënies dhe cilësisë së jetesës të banorëve, zbutjes të nivelit të papunësisë, forcimin e rendit e të qetësisë publike dhe zhvillimin e infrastructures urbane e rurale. Dhënia e mendimeve e sugjerimeve të ndryshme në funksion të përmirësimit të këtyre problemeve na ka obliguar që të bëhemi pjesë funksionale e sensibilizimeve dhe gjetjes së investimeve e investitorëve.

4. Zyra e Nën/Prefektit ka qenë gjithmonë e hapur dhe bashkëpunuese me banorët e Kolonjës duke adresuar problematikat dhe kërkesat e tyre ne institucionet pergjegjese dhe zgjidhur në masë të pëlqyeshme ato.

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve me Pushtetin Vendor, Bashki e Njësi Administrative, Kryepleq, organizata dhe shoqata të ndryshme për parandalimin e fenomeneve të trafikimit të qënieve njerëzore, ndihma ndaj shtresave në nevojë dhe të fëmijëve që braktisin shkollën dhe të fenomeneve të tjera negative që shqetësojnë

1. Në bashkëpunim me Komisaratin e Policisë Kolonjë dhe strukturave rajonale, kemi organizuar takime në Njësite Administrative si dhe në shkollat e mesme të Bashkisë Kolonjë me qëllim parandalimin e fenomenit të trafikimit dhe pavarësisht se ky fenomen nuk ka qenë i pranishëm, puna parandaluese vazhdon të jetë në fokusin e objektivave kryesore.

2. Për trajtimin e shtresave në nevojë, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për trajtimin e tyre me ndihma ushqimore, veshmbathje, sigurim ambientesh banimi etj. Gjatë vitit që kaloi, në bashkëpunim me fondacione e organizata humanitare, u nda një sasi e konsiderueshme me pako me ndihma ushqimore si dhe u trajtua me ndihmë një familje në fshatin Starje, shtëpia e të cilëve u dogj nga zjarri.

Bashkëpunimi me pushtetin vendor për realizimin e programeve të zhvillimit për ritjen ekonomike nëpërmjet shfrytëzimit të resurseve natyrore e njerëzore, kryesisht zhvillimin e turizmit, agroturizmit dhe politikave të punësimit.

1. Pavarësisht domosdoshmërisë për përmirësimin e klimës të bashkëpunimit nga ana e administratës së bashkisë në drejtim të thjeshtimit dhe ritmit të kryerjes së procedurave ligjore të këtyre aktiviteteve, nga ana e jonë janë bërë shumë përpjekje për të gjetur forma dhe mënyra të afrimit të investitorëve dhe investimeve vendas e të huaj, për transparencën e procedurave të miratimit të këtyre aktiviteteve.

2. Të gjitha këto bëhen të realizueshme vetëm nëpërmjet bashkëpunimit efikas ku hallka më e rëndësishme mbetet bashkëpunimi mes pushtetit vendor, institucionit të Prefektit, si dhe atij qendror.

3. Kemi marrë pjesë disa herë në takimet me banorët për të dëgjuar dhe për tu dhënë zgjidhje ankesave të tyre në lidhje me vendim-marrjet e Këshillit të Bashkisë Kolonjë, të cilat kërkojnë dëgjuesë publike, sipas përcaktimeve në dispozitat ligjore.

Situatat emergjente që u paraqiten në muajt e dimrit si dhe ato të verës:

Janë ndjekur dhe monitoruar situatat emergjente si në dimër edhe gjatë muajve të nxehtë të verës dhe përgjithësisht nuk pati ngjarje të jashtëzakonshme, të cilat të çonin në fatkeqësi natyrore a njerëzore.

Si rezultat i organizimit të kontrolleve dhe marrjes së informacioneve në kohën e duhur, prej të gjitha institucioneve si dhe kërkesa që çdo institucion që vepron në territorin e nënprefekturës të hartonte planin e detajuar për përballimin e situatave emergjente, mund të themi se u eliminuan shumë probleme.

Viti 2024 pavarësisht se u karakterizua nga temperatura te larta gjatë verës, pati një rënie drastike të rënies së zjarreve, si rezultat i masave të marra parandaluese dhe bashkëpunimit mes institucioneve dhe shtabeve të emergjencave civile.

Bashkëpunimi me kompanitë e mirëmbajtjes së akseve rrugore si në stinën e verës, po ashtu dhe atë të dimrit, bëri të mundur që Kolonja të vizitohej në dimër pa probleme në kalushmërinë e rrugëve nacionale dhe ato në zonat turistike.

Dhe kete vit u organizuan kontrole të vazhdueshme në kompanitë private që merren me shfrytëzimin dhe mbarështrimin e pyjeve, për masat e marra prej tyre për parandalimin e zjarreve dhe rrëshqitjeve si dhe kapacitet njerëzore e mjetet që kanë në dispozicion të parandalimit e ndërhyrjes në raste të rënies së zjarreve.

#### Administrimi dhe kontrolli i territorit ka qënë një ndër prioritet kryesore.

Në këtë kuadër u angazhuam në mbikqyrjen, kontrollin dhe verifikimin në institucionet qëndrore në nivel vendor dhe qeverisjen vendore lidhur me punën e bërë dhe masat e marra për ngritjen dhe funksionimin i shtabeve dhe grupeve për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike. Organizuam takime si dhe mbajtëm kontakte të vazhdueshme me kryepleqtë e fshatrave dhe banorëvë për veprime e informime që ndihmojnë në parandalimin dhe evidentimin e kultivimit të bimëve narkotike. Organizuam aktivitete nëpër shkollat 9 vjecare dhe të mesme, për sensibilizimin e opinionit për efektet negative të kultivimit dhe përdorimit të lëndëve narkotike.

Vend të veçantë i kushtuam përmirësimit të mjedisit në aspektin higjienosanitar, në atë të sigurisë dhe përmirësimit infrastrukturor të zhvillimi të turizmit dhe si rezultat i kësaj pune u arrit që sezoni turistik i vitit që shkoi të ishte një vit shumë i suksesshëm, duke ritur ndjeshëm fluksin e turistëve të huaj e vendas.

#### Promovimi i vlerave kulturore dhe monumenteve historike

Njohja dhe evidentimi i vlerave kulturore, folklorit, monumeteve të kulturës, figurave të shquara të Rilindjes Kombëtare dhe historike të Nënprefekturës, gërshëtimi i vlerave tradicionale me ato bashkëkohore në funksion të edukimit por dhe ofrimit të tyre ndaj fluksit të madh të turistëve të huaj e vendas, ka qënë një aspekt tjetër i punës sonë dhe konstatojmë se si rezultat i promovimit apo reklamimit qoftë dhe nëpërmjet rrjeteve sociale, guidat turistike patën një shtrirje më të gjerë. Megjithatë në këtë drejtim, duhet të punohet më shumë në ngritjen dhe funksionimin e zyrave të informimit të të gjitha vendeve dhe objekteve atraktive.

#### **V: Nënprefektura Devoll:**

Gjatë vitit 2024, në qendër të vëmendjes së Nën-Prefektit të Devollit ka qënë ndjekja, organizimi, dhe menaxhimi i situatave të krijuara në periudhën e dimrit dhe të verës, mbështetja sociale për shtresat në nevojë, promovimi i turizmit dhe vendeve me potencial turistik në Bashkinë Devoll, paketa e sigurisë në shkolla, ndjekja dhe organizimi i aksionit të pastrimit të territorit nga Institucionet Qendrore në Devoll, takimi me bizneset e ndryshme që operojnë në Bashkinë Devoll, ndjekja e proceseve të programeve mbështetëse të të ardhurave të qeverisë shqiptare ndaj fermerëve, etj.

I është kushtuar një vëmendje e veçantë promovimit turistik, duke e promovuar në rrjete sociale, por dhe me takime dhe festa lokale, atraksionet më të mira turistike në Bashkinë Devoll. Gjithashtu, i është kushtuar vëmendje aksioneve të pastrimit në këto pika, si dhe pikës kufitare Kapshticë, e cila është kontakti i parë i të huajve që hyjnë nga shteti fqinj i Greqisë.

Në bashkëpunim me Sektorin e Mbështetjes Sociale dhe institucioneve të tjera jo-qeveritare dhe humanitare janë diskutuar dhe trajtuar çështje dhe raste të ndryshme të personave apo familjeve me probleme sociale në Bashkinë Devoll, si dhe problematikave me emigrantët nga vendet e Lindjes së Mesme, që hyjnë në territorin shqiptar( të mitur të cilët trajtohen si viktima të mundshme të trafikimit)

Janë zhvilluar takime me institucionet përgjegjëse (policinë e shtetit, Bashkinë Devoll, kryetarët e fshatrave, banorë të zonës, etj) ku është diskutuar fenomeni i vendosjes së zjarreve në kullota dhe pyje dhe masat për parandalimin e këtij fenomeni të dëmshëm për zonën.

Gjithashtu, për periudhën e dimrit i është kushtuar rëndësi emergjencave sezonale. Së bashku me administratorët, janë diskutuar problemet e mundshme që kanë dalë, rrezikun e pemëve në rrugë, problemet e përmytjeve nga përrrenjtë dhe aksesimin e të gjitha rrugëve në të gjitha fshatrat në periudhën e dimrit nga banorët, duke u kujdesur që të gjitha rrugët të jenë të hapura dhe të kriposura.

I është dhënë një rëndësi e veçantë edhe mënyrës së funksionimit të institucioneve në lidhje me pritjen e qytetarëve, duke siguruar që të gjitha institucionet t'i përmbahen legjislacionit në fuqi dhe t'i zgjidhin problematikat e qytetarëve.

Nën-Prefekti Devoll, me detyrë të veçantë të deleguar për Arkivin e Gjendjes Civile të Bashkisë Devoll, ka pritur dhe ju ka shërbyer të gjithë qytetarëve të paraqitur pranë sportelit të kësaj zyre.

Gjatë vitit 2024 i është kushtuar një rëndësi e veçantë zhvillimit ekonomik dhe turistik të vendeve turistike, të cilat janë një aset shumë i rëndësishëm për zhvillimin e zonës, si dhe për bizneset që operojnë në Bashkinë Devoll. Ndërtimi i infrastrukturës së brendshme dhe shesheve të fshatit Qyteze, dhe rregullimi i infrastrukturës rrugore për segmentet Sinice-Dardhë si dhe Arrzë-Dardhë e cili ka përfunduar, dhe këto investime pritet t'i japin zonës një zhvillim ekonomik dhe turistik të madh.

N/Prefekti Devoll, gjatë vitit 2024 ka realizuar këto takime:

- Së bashku me Drejtoreshën e Shkollës Profesionale Teknike në Korçë, dhe Drejtorin e Zyrës Vendore të Punësimit në Devoll, zhvilluam takime me disa nga bizneset e Devollit dhe përfaqësues të Bashkisë Devoll. Diskutuam mbi mundësitë që ofron arsimit profesional, si dhe sfidat e lehtësitë që do të hasë biznesi në formimin dhe shkollimin profesional të nxënësve dhe plotësimin e vendeve vakante.
- Ka zhvilluar takime në institucionet vendore me tematika të ndryshme, duke përfshirë mënyrën se si ofrojnë shërbimet ndaj qytetarëve, tematika festive dhe problematika të ndryshme në lidhje me punën e përditshme me qytetarët.
- Takim me fermerë të Bashkisë Devoll, së bashku me Prefektin e Qarkut, për të diskutuar mundësi të reja, veçanërisht sa i përket organizimit dhe bashkëpunimit midis blektorëve dhe organizmave mbështetës në këtë fushë. Gjatë takimit, u diskutua jo vetëm për çështjet e sipërpërmendura, por edhe për shqetësimet e tyre.

- Takime të ndryshme me fokus të rinjtë, institucionet arsimore, mundësitë që u ofrohen nxënësve, paketën e sigurisë në shkolla dhe përfshirjen e tyre në qeverisjen e institucioneve vendore nëpërmjet këshillave rinore, etj.
- Ka zhvilluar një sërë takimesh në Bashkinë Devoll me fokus menaxhimin e emergjencave, duke përfshirë si ato verore, ashtu edhe ato dimërore. Në këto takime, është vënë theksi te parandalimi, i cili mbetet një shtyllë themelore për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Është theksuar rëndësia e takimeve të rregullta me banorët dhe institucionet vendore për të forcuar ndërgjegjësimin dhe gatishmërinë në raste situatash emergjente.

Për të parandaluar dhe minimizuar pasojat, janë vendosur prioritetet si më poshtë:

- Parandalimi aktiv: Përmes inspektiveve të herëpashershme në zonat e riskut dhe analizave të vazhdueshme të situatave, është garantuar një qasje proaktive në identifikimin dhe eliminimin e kërcënimeve potenciale.
- Bashkëpunimi institucional: Është konsoliduar një rrjet bashkëpunimi ndërmjet aktorëve kryesorë të shtabit të emergjencave në Bashkinë Devoll. Kjo përfshin koordinimin e veprimeve dhe ndarjen e informacioneve kritike në kohë reale.
- Vrojtimi dhe sinjalizimi: Janë ngritur mekanizma efektivë për monitorimin e zonave me risk dhe raportimin në kohë të problematikave, duke siguruar kështu një ndërhyrje të shpejtë dhe të mirëkoordinuar.
- Informimi i komunitetit: Përmes aktiviteteve sensibilizuese dhe shpërndarjes së informacionit të dobishëm, është rritur ndërgjegjësimi i banorëve për mënyrat më të mira të reagimit në situata emergjente.
- Ndërhyrja e menjëhershme: Janë hartuar protokolle të detajuara për reagimin e shpejtë në rast emergjencash, duke përfshirë mobilizimin e burimeve njerëzore dhe materiale.
- Ky angazhim i vazhdueshëm synon jo vetëm menaxhimin efikas të emergjencave, por edhe krijimin një kulture të qëndrueshme të sigurisë dhe bashkëpunimit në nivel komunitet.
- Ka marrë pjesë në një sërë takimesh dhe festash të ndryshme tradicionale të zonës së Devollit, si edhe në takime me institucionet fetare për të shprehur urimet për festat fetare. Gjithashtu, kam zhvilluar takime me organizatën e veteranëve për data përkujtimore dhe kam marrë pjesë në festat tradicionale të Bashkisë Devoll.
- Takime të ndryshme me fermerë dhe biznese të zonës, duke u fokusuar në dëgjimin e problematikave që ata hasin gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre, si dhe për të diskutuar mënyrat për përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e efikasitetit të tyre. Gjatë këtyre takimeve, është trajtuar me rëndësi edhe informimi mbi skemat e mbështetjes financiare dhe programet që qeveria shqiptare ofron për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë aktivitetin e tyre dhe të kontribuojnë në mënyrë më efektive në zhvillimin ekonomik të rajonit tonë.
- Së bashku me Prefektin e Qarkut, kemi inspektuar një sërë projektesh në Bashkinë Devoll, të cilat përfaqësojnë investime të rëndësishme të qeverisë shqiptare për përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve. Këto projekte synojnë gjithashtu t'i japin zhvillim ekonomik, si dhe zhvillimin e turizmit të kësaj zone, duke krijuar mundësi të reja për komunitetin dhe përmirësuar infrastrukturën lokale.
- Ka marrë pjesë në takime të ndryshme me tematika kulturore të organizuara në Bashkinë Devoll, duke mbështetur iniciativat për promovimin e kulturës dhe traditave të zonës.
- Në kuadër të muajit kundër trafikimit të qenieve njerëzore, janë zhvilluar aktivitete sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese në shkolla të ndryshme të Bashkisë Devoll.

- Në gusht të vitit 2024, kam drejtuar Komitetin Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave, ku morën pjesë të gjitha institucionet e Qarkut Korçë si anëtarë të këtij komiteti, duke koordinuar veprimtaritë për parandalimin dhe trajtimin e kësaj problematike.
- Ka marrë pjesë në komitete dhe takime të ndryshme të thirrura nga Prefekti i Qarkut, për çështje që lidhen me Bashkinë Devoll, por edhe për çështje me rëndësi më të gjerë për rajonin në tërësi.
- Jane trajtuar nga N/Prefekti kryesisht probleme që lidhen me Bashkinë, çështje pronësie, ndotjen e mjedisit, kërkesa për punësim, konflikte, probleme që dalin nga takime ditore me qytetarët.

Nisur nga ankesat dhe takimet me qytetarët, po evidentohen disa nga problematikat që kërkojnë zgjidhje:

1. Pastrimi i rrugëve rurale, hapja e kanaleve vaditëse dhe çakullimi i rrugëve të arave në Bashkinë Devoll vazhdon të mbetet një problem i rëndësishëm.
2. Vonesa të shumta në nxjerrjen e certifikatave të pronësisë (legalizimeve) për shtëpitë e ndërtuara para vitit 1991 dhe për legalizimet e reja.
3. Vijat e bardha dhe sinjalistika rrugore mungojnë në rrugët kryesore dhe të brendshme, veçanërisht pranë shkollave, çka e bën ndërhyrjen të domosdoshme.
4. Ndërtimi ose gjetja e një ambienti për kafshët endacake, të cilat shpeshherë përbëjnë një shqetësim të madh për qytetarët.
5. Hapja e rrugëve malore për të lehtësuar qarkullimin e mjeteve zjarrfikëse në rastet e rënies së zjarreve.
6. Rishikimi i linjës elektrike të fiderit 8 (Bilisht-Arrzë), një problematikë e hershme që kërkon zgjidhje.
7. Nxitja e banorëve të fshatrave të Devollit të Sipërm (me politika lehtësuese nga Bashkia Devoll) për ngritjen e kapaciteteve pritëse për turistët.
8. Shtrimi me asfalt i rrugës Vidohovë-Miras.
9. Ndërhyrje në urën në hyrje të fshatit Progër, një problematikë e ngritur nga administratori i zonës për amortizimin e saj dhe rrezikshmërinë në kalimin e mjeteve.
10. Politika që nxisin bashkimin e fermerëve, duke krijuar më shumë mundësi për të përfituar nga skemat e mbështetjes financiare nga qeveria.

## **VI: Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave:**

Gjatë vitit 2024 puna e Sektorit të Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile ka synuar:

1. Në marrjen e masave përgatitore për hartimin e Dokumenteve Strategjike në nivel qarku e bashki dhe zhvillimin e mëtejshëm të konceptit për mbrojtjen civile të popullatës në bashki, institucione dhe komunitet.
2. Administrimin sa më të mirë të emergjencave civile dhe të situatave problematike të krijuara nga fatkeqësi të ndryshme natyrore.
3. Rritjen e aftësive profesionale të strukturave të EC dhe përmirësimin e kapaciteteve operacionale të MC në nivel vendor, etj.

Duke parë kontekstin e përgjithshëm të ndryshimeve klimatike të menjëhershme, moti i nxehtë temperatura të larta, thatësi e tejzgjatur, reshje shiu e dëborë me intensitet të lartë brenda një kohë të shkurtër, vjeshtë e dimër pa langështirën e nevojshme e fenomene të tjera, është e nevojshme që të thellohet më tej mendimi për Mbrojtjen Civile në përgjithësi dhe për Emergjencat Civile Verore e Dimërore në veçanti, *duke mos i reduktuar ato thjesht dhe vetëm në probleme teknike për administrimin e një situatë të rënies së zjarreve, apo në përballimin e një situatë dimërore, për këtë:*

- Është punuar për njohjen dhe zbatimin e ligjit Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” si dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore.
- Janë zhvilluar takime me drejtuesit e bashkive dhe të institucioneve shtetërore lidhur me metodologjinë e hartimit dhe të përgatitjes së Dokumenteve Strategjike në Nivel Vendor dhe është në përfundim puna për hartimin e tyre.
- Janë zhvilluar takime e kontakte të vazhdueshme me bashkitë, institucionet shtetërore në nivel rajonal e vendor, me strukturat e MC për njohjen dhe zbatimin e detyrimeve për mbrojtjen civile të popullatës në rast fatkeqësish natyrore.
- Janë organizuar fushata sensibilizuese me komunitetin në veçanti në zonat me risk të lartë lidhur me detyrimet ligjore për mbrojtjen e pasurisë private e publike nga fatkeqësi të ndryshme, domosdoshmërinë e marrjes së masave dhe bashkërendimin e punës për përballimin e tyre.
- Është bashkëpunuar me bashkitë dhe strukturat e policisë së shtetit për vënien para përgjegjësisë ligjore të personave që shkaktojnë situata problematike në veçanti për zjarrvëniet e qëllimshme.
- Janë hedhur hapa të rëndësishëm në drejtim të njohjes dhe evidentimit të risqeve, koordinimi i punës dhe marrja e masave parandaluese për zvogëlimin e efekteve dhe të pasojave të tyre negative, të cilat reflektohen dhe pasqyrohen në dokumentacionin përkatës, si dhe në veprimet konkrete të strukturave të EC dhe atyre operacionale.

Mbështetur në përvojën e deritanishme si dhe në punën e bërë për vlerësimin e risqeve paralelisht është punuar në drejtim të marrjes së masave parapërgatitore me synim minimizimin e efekteve dhe të pasojave që mund të shkaktohen nga fatkeqësi natyrore, për këtë:

- Kemi evidentuar problematikat që kanë digat e rezervuarët në veçanti digat e mëdha, puna e bërë dhe masat e marra nga Drejtoria Rajonale e Ujitjes e Kullimit dhe bashkitë në këtë drejtim, organizimi i takimeve të veçanta dhe bashkëpunimi me Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha për problematikat e shfaqura.
- Mbajtjen në gadishmëri e monitorim të vazhdueshëm të Hidrovorit të Tushemishtit, Digës së Zëmbllakut, stacioneve të pompimit, të pritave përgjatë lumenjve dhe kanaleve ujitëse e kulluese, etj.
- Monitorimin e vazhdueshëm i argjinaturave të lumenjve, si dhe të kanaleve të parë dhe kolektorëve në fushën e Korçës, Maliqit dhe Buçimas Pogradec.
- Evidentimi i rreziqeve që mund të shkaktohen nga rrëshqitjet e dherave dhe gurëve në segmentet rrugore nacionale e dytësore e lidhëse.
- Organizimi i takimeve me Drejtorinë e Rajonit Qëndër-Lindje Korçë, subjektet kontraktore që mirëmbajnë akset kryesore nacionale dhe rrugët turistike, puna e bërë dhe masat përgatitore për sigurimin e qarkullimit normal në këto segmente, gatishmëria e teknikës dhe personelit manovrator, vend dislokimi i kripës dhe të materialeve të tjera inerte, pastrimin e kanaleve anësore, kontrolli dhe hapja e tombinove, gadishmëria teknike e mjeteve etj.



- Evidentimi i zonave problematike të furnizimit me energji elektrike në veçanti në zonat rurale dhe malore Gorë, Panarit, Lekas, Pustec, Mokër etj, organizimi i takimeve të përbashkëta pune me OSSHEE dhe OST Korçë lidhur me masat përgatitore për minimizimin e defekteve në rrjetin e furnizimit me energji elektrike në këto zona dhe gatishmërinë e kapaciteteve për ndërhyrje, etj.
- Organizimi i takimit me Komisionin e Mbrojtjes Civile në shkallë qarku për administrimin e EC Verore e Dimërore.

Administrimi i emergjencave civile dhe të situatave problematike të krijuara, një nga prioritet kryesore duke i kushtuar rëndësi fazës dhe punës parapërgatitore, si faktor kryesor për administrimin e rasteve të rënies së zjarreve dhe minimizimin e pasojave të shkaktuara prej tyre, për këtë:

- Kemi planifikuar dhe realizuar rreth 35 masa dhe i veprimtari të ndryshme gjatë periudhës Prill-Qershor dhe Korrik-Gusht 2024.
- Organizimi i takimeve të përbashkëta pune në nivel prefekturë, bashkie, njësi administrative fshatra e zona më me risk, me sektorët e EC, Shërbimin e MZSH-së, Shërbimin pyjor, Administ. Rajonale të ZM, përfaqësues të Policisë së Shtetit dhe të institucioneve të tjera shtetërore në nivel vendor, ripreçizimi dhe njohja e detyrave dhe radhës së punës në rast rënie të zjarrit, etj.
- Riorganizimi i sistemit të vrojtimit-sinjalizimit, skemave të informimit dhe të komunikimit ndërmjet komisioneve të mbrojtjes civile të bashkive, ngritja e grupeve e skuadrave vullnetare në zona të caktura.
- Mbajtja në gatishmëri e kapaciteteve operacionale, pajisja dhe trajnimi i tyre, etj.
- Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimi i veprimeve me strukturat e MC të bashkive për ndërhyrjen në kohë dhe minimizimin e dëmeve të shkaktuara nga rastet e rënies së zjarreve dhe fatkeqësi të tjera.

#### ECV-Treguesit

- Janë administruar mirë EC Verore si dhe situatat e ndryshme problematike, në veçanti rastet e rënies së zjarreve gjatë periudhës Korrik-Gusht, në ekonominë pyjore Bode-Gorë të Bashkisë Maliq, Parkun Kombëtar të Prespës, si dhe në fshatin Niçë Bashkia Pogradec.
  - Përmirësimi i bashkëpunimit midis strukturave në bashki dhe i bashkive me njëra tjetrën.
- Kontributin e përbashkët për fikjen e zjarrit të rënë në ekonominë pyjore Bode-Gorë, të Bashkisë Maliq, pjesëmarrja dhe kontributi për fikjen e zjarrit të rënë në Parkun Kombëtar të Prespës, etj.
- Informimi në kohë dhe ndërhyrja efikase për fikjen e zjarrit të rënë në fshatin Shtyllë, Njësia Administrative Vithkuq, Bashkia Korçë duke mundësuar izolimin pa lejuar prekjen e kurores me pisha.
  - Administrimi i mirë i situatës së zjarreve nga Bashkia Kolonjë.
  - Ndërhyrja në kohë nga forcat e Bashkisë Devoll për fikjen e zjarreve duke mos lejuar përhapjen e tyre.
  - Reagimi i menjëhershëm i shërbimit të MZSH-së dhe forcave të tjera në bashkinë Pogradec për fikjen e zjarrit të rënë në Vorrezat e Fshatit Guras.
  - Aktivizimi i mirë i grupeve të banorëve apo skuadrave vullnetare nga Bashkia Korçë, Kolonjë dhe Devoll.

- Raportimet në kohë dhe përlogaritjet e sakta të kryera nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Korçë në veçanti për zjarrin e rënë në Parkun Kombëtar të Prespës, dhe referimin në polici të dokumentacionit për zjarrvëniet e qëllimshme, etj.

Tabela me rastet e rënies së zjarreve Janar-Dhjetor 2024.

N/r	Bashkia	Rastet e rënies së zjarrit			Gjithësej	Forca të angazhuara	Automjet të agazhuara.	Sip.pyjore përshkruar nga zjarri	Sip.kullotë e përshkruar nga zjarri
		Objekt. bazë ushqim. blegtorale	Pyjore	Kullota, shkurre, tokë bujqësore.					
1	Korçë	9	2	5	16	203	41	4.5	16.5
2	Pogradec	8	5	5	18	234	36	33.7	31.3
3	Maliq	13	2	11	26	754	159	150.7	14.3
4	Devoll	5	2	12	19	212	60	5	39
5	Kolonjë	8	7	3	18	281	54	13.9	9
6	Pustec	2	1	6	9	796	94	434	1873
	Totali	45	19	42	106	2.480	444	491	1.983

- Rastet e rënies së zjarreve ruajnë relativisht të njëjtin ritëm nga 91 raste në vitin 2023, në 106 raste për vitin 2024.
- Tërheqin vëmendjen 17 rastet e rënies së zjarreve në sipërfaqe me pyje, pishë, ah dhe të përzier duke djegur sipërfaqe më të madhe nga 24 ha që ishte në vitin 2023 në 230 ha në vitin 2024, si në ekonominë pyjore Bode-Gorë, fshatin Niçë dhe Parkun Kombëtar të Prespës, ndërsa sipërfaqja e përshkruar nga zjarri gjatë kësaj periudhe shkon deri në 2450 ha (kullota, barishte, sermishtë, ferra e shkurre) dhe 430 ha sipërfaqe e përshkruar në pyje.
- Kohëzgjatja për fikjen e zjarreve ishte e madhe 7-15 ditë.
- U përdorën forca dhe mjete shtesë për fikjen dhe normalizimin e situates (nga Rep.Usht 1033 Drenovë, Komanda Mbështetëse Tiranë dhe përdorimi i helikopterit në kuadrin e Mekanizimit Evropian të Mbrojtjes Civile).

Tabela përmbledhëse me rastet e rënies së zjarreve (2022-2024)

N r	Bashkia	Në banesa, bazë ushqimore blegtorale, objekte të ndryshme			Në sipërfaqe pyjore, kullota, barishte, shkurre, toka të korrura etj.			Automjete të angazhuara në shuarjen e zjarreve			Forca të angazhuara në shuarjen e zjarreve			Kapacitetet e deklaruara			Kapacitetet e angazhuara		
		VITI	VITI	VITI	VITI	VITI	VITI	VITI	VITI	VITI	VITI	VITI	VITI	VITI	VITI	VITI	VITI	VITI	
		2022	2023	2024	2022	2023	2024	2022	2023	2024	2022	2023	2024	2022	2023	2024	2022	2023	2024
1	Korçë	11	7	9	7	4	7	19	21	41	242	167	203	120	225	225	242	167	179

2	Kolonjë	7	5	8	28	9	10	53	34	54	260	139	281	380	150	64	260	139	222
3	Devoll	5	5	7	12	12	12	18	23	60	150	174	212	250	153	310	150	174	148
4	Maliq	13	3	15	9	7	11	42	21	159	195	124	754	342	458	100	195	124	712
5	Pogradec	7	8	8	12	7	10	25	21	36	175	87	234	90	260	760	175	87	167
6	Pustec	2	0	2	2	2	7	3	3	94	26	28	796	35	35	32	26	28	31
	<i>Total</i>	45	26	45	70	41	61	160	123	444	1048	719	2480	1217	1281	1491	1048	719	1459

### Problematikat:

- Mungesa e vijueshmërisë fillestare për zjarrin e rënë në fshatin Niçë, Njësia Administrative Dardhas, Bashkia Pogradec, zjarrin në Parkun Kombëtar të Prespës, dhe zjarrin e rënë në ekonominë pyjore Bode-Gorë, Bashkia Maliq, gjë e cila çoi në agravimin e situatës me shtrirje kohore në disa ditë dhe ndërhyrjen e forcave dhe të kapaciteteve shtesë.
- Mungesa e pajisjes dhe kompletimit të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura me stacion, sektor të shërbimit të MZSH-së dhe pajisje të tjera për mbrojtjen nga zjarri, etj.
- Aktivizimi jo në kohë e grupeve vullnetare në Bashkinë Pogradec e Maliq për zjarrin e rënë në Niçë dhe Bode-Gorë.
- Vështirësi janë hasur dhe në ngritjen e aktivizimin e banorëve, grupeve apo skuadrave vullnetare, bashkitë i deklarojnë si kapacitete, por nuk ka aktivizim të tyre.
- Akordimi i fondeve për të mundësuar hapjen dhe çakullimin e rrugëve autopyjore si masë parandaluese për krijimin e mundësisë së aksesit në kohë sa më të shpejtë me vatrën.
- Mungesa e theksuar e rrugëve autopyjore, parcelizimi i sipërfaqeve pyjore apo ndarja e tyre me rrugë autopyjore për përdorimin e automjeteve, në veçanti në ekonominë pyjore Bode-Gorë në Bashkinë Maliq dhe Parkun Kombëtar të Prespës ku pothuajse mungonte ose kishte dëmtime serioze të rrugëve të cilat nuk lejonin përdorimin e automjeteve për fikjen e zjarrit, etj.
- Mos pastrimi i humusit dhe i sipërfaqeve të pyjeve nga degët e thata, etj.
- Gjithashtu, në sipërfaqet me pyje ka dëmtime dhe në disa raste mungesë të lerave të ujit apo burimeve të tjera alternativë ujore për përdorimin në rast zjarri dhe situata emergjente, mungesa e pastrimit të sipërfaqeve pyjore nga degët e thata dhe ato të panevojshmet, të cilat vështirësojnë më tej ndërhyrjen e forcave dhe të automjeteve për fikjen e zjarrit, faktorë të cilët duhet të vlerësohen dhe të merren në konsideratë nga bashkitë, strukturat e Shërbimit Pyjor dhe Administrata Rajonale Zonave të Mbrojtura.
- Nga 106 raste të zjarreve, 42 prej tyre ose 40 %, janë në tokë bujqësore, ku nga djegia e pakontrolluar e mbeturinave në tokat bujqësore shpesh herë situata del jashtë kontrollit, duke u kthyer në risk serioz për përhapjen e zjarreve, si psh, djegia e tokës torfike në fshatin Sheqeras në Bashkinë Maliq ngelet një shqetësim i vazhdueshëm dhe një risk i shtuar.
- Raportimi me vonesë i informacionit paraprak dhe përfundimtar, si dhe shoqërimi me dokumentacionin e nevojshëm të rasteve të rënies së zjarreve, e cila rezulton pothuajse në të gjitha bashkitë dhe duhet përmirësuar.

- Nuk janë rifreskuar urdhërat e drejtuesëve të bashkive për ngritjen e Komisionit të Konstatimit të gjendjes dhe vlerësimit e dëmeve, përllogaritje jo të sakta të vlerës në orendi a pajisje duke mos marrë në konsideratë çmimin për njësi të artikujve-orendi e pajisje të dërguar nga Administrata e Përgjithshme Tatimore dhe Këshilli i Qarkut.
- Kërkohet më shumë bashkëpunim me strukturat e vëtë bashkive, që nga momenti i ndodhjes të një situatë në veçanti të rasteve të rënies së zjarrit, plotësimin e informacionit të nevojshëm deri në raportin përfundimtar i cili duhet të jetë më i plotë, duke e përshkruar arsyet e ndodhjes, shkakun, personat përgjegjës, masat e marra për të mos lejuar këto fenomene, etj.

#### Administrimi Ec Dimërore:

Marrja e masave përgatitore, është parë me përparësi, për këtë:

- Kemi planifikuar e zhvilluar disa takime pune të përbashkëta me strukturat e EC, shërbimin e ujitjes dhe të kullimit në bashki, subjektet kontraktore që mirëmbajnë akset kryesore nacionale e rrugët turistike, drejtoritë/sectorët e shërbimeve në bashki për rrugët dytësore dhe ato lidhëse, për saktësimin e detyrave dhe të segmenteve sipas kushteve të kontratës, gjendjen e rezervuarëve dhe të ujëmbledhësve, gatishmërinë e personelit, problemet në ndjekje.
- Përgatitja dhe dërgimi në bashki dhe institucionet shtetërore në nivel rajonal e vendor të programit të punës dhe të dokumenteve që lidhen me administrimin e EC Dimërore.
- Gjendja e furnizimit dimëror, ngrohja në institucionet arsimore dhe shëndetësore.
- Mbledhja dhe përpunimi i informacioneve, relacioneve të ardhura nga bashkitë, institucionet, evidentimi i problematikave të ndryshme, informimi i prefektit dhe AKMC.
- Komunikimi i vazhdueshëm lidhur me situatat problematike të krijuara dhe bashkëpunimi me strukturat përkatëse për normalizimin e situatës.
- Vëzhgime, sondazhe e verifikime të ndryshme në terren në bashki, subjektet kontraktore lidhur me marrjen e masave dhe gatishmërinë për të përballuar situatat problematike, etj.
- Përvoja e mirë që është fitura në mirëmbajtjen e segmenteve kryesore nacionale dhe ato turistike duhet të shtrihet edhe në drejtim të mirëmbajtjes së rrugëve dytësore e lidhëse në bashki, shesheve dhe qëndrave kryesore të qyteteve, etj.

Gjatë vitit 2024 një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe përdorimi i fondit të kushtëzuar në fushën e mbrojtjes civile, si dhe mbështetja me projekte të ndryshme për kryerjen e punimeve mbrojtëse rehabilituese, përmirësimin e strukturave të MC dhe të kapaciteteve operacionale, si dhe projektet e fituese në programin për digat, me të cilin është *mundësuar*:

- Pastrimi i mjaft shkarkuesve katastrofike nga inertet në disa rezervuar si dhe dëmtime të ndryshme në sistemin e lëshimit, furnizimit të ujit, etj.
- Vënia në funksionim e stacionit të pompimit në fshatin Vreshtas të bashkisë Maliq.
- Është ndërhyrë nga bashkitë Korçë, Kolonjë dhe në mjaft prita malore që rrezikonin daljen e përrrenjve nga shtrati dhe përmytje të banesave e toka bujqësore.
- Është ndërhyrë nga të gjitha bashkitë në shtrimin dhe përmirësimin e disa segmenteve rrugore dytësore e lidhëse, rrugëve autopsyjore e ndihmëse në zona me sipërfaqe pyjore, etj.

- Janë blerë materiale e pajisje të ndryshme nga sektorët e EC dhe shërbimi i MZSH-së duke përmirësuar e rritur kapacitetet operacionale, etj.

Çështje për tu ndjekur në vijim:

- Përfundimi i procesit të hartimit të Dokumenteve Strategjike në nivel vendor. Nga ana e përmbajtjes dhe përgatitjes dokumentet si Vlerësimi i Riskut në nivel vendor, Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe Plani Vendor për Emegjencat Civile nuk janë përgatitur sipas detyrave dhe kërkesave që shtrohen në aktet ligjore e nënligjore, ato duhet të jenë të harmonizuara me dokumentet në nivel qendror, të prefekturës dhe me qarqet dhe bashkitë fqinje.
- Në dokumentin kryesor që është Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë nuk është identifikuar, lloji, karakteristikat dhe prejdardhja e risqeve nga fatkeqësitë, niveli i ekspozimit dhe cënueshmërisë, etj, dhe mbi këtë bazë të vijojë puna me dokumentet e tjera si Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut duke i shtrirë në kohë dhe sipas mundësive financiare punën dhe masat për shmangien ose zvogëlimin e pasojave që mund të shkaktohen deri në planin konkret të EC në bashki.

Shkalla e përgatitjes apo përfundimit të tyre paraqitet sipas tabelës

Nr	Bashkitë	Vlerësimi i Riskut	Strategjia Vendore ZRF	Plani Vendor për EC
1	Prefektura	po	-	po
2	Bashkia Korçë	po	jo	jo
3	Bashkia Pogradec	jo	jo	jo
4	Bashkia Maliq	po	jo	jo
5	Bashkia Devoll	po	jo	jo
6	Bashkia Kolonjë	po	po	po
7	Bashkia Pustec	jo	jo	jo

- Gjendja e digave të mëdha dhe përgatitja e planeve të gatishmërisë, sipas udhëzimeve të dhëna nga KKDM, përgatitja me vonesë e raporteve teknike dhe aplikimi i dobët nga bashkitë në fondin për digat të çelur nga AKMC.
- Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dytësore apo lidhëse në bashki, amortizimi i tyre.
- Mosfunksionimi i kanaleve anësore (bllokimi dhe zënia e tyre nga ndërtimet dhe zaptimi i tokës bujqësore) në aksin nacional Fshati Gështenjas-Buçimas-Pogradec dhe Pogradec-Tushemisht, të cilat krijojnë përmbytje në bizneset dhe tokat bujqësore anës rrugës nga reshjet intensive të shiut në këtë zonë .
- Stacionet e pompimit në të gjitha bashkitë kanë problematikat e veta, mungesa linjës elektrike dytësore për furnizimin me energji elektrike të hidrovorit në Fshatin Tushemisht, etj.
- Më mirë duhet të evidentohen risqet në çdo bashki dhe mbi këtë bazë të orientohet përdorimi i fondit të kushtëzuar dhe projektet fituese në fushën e mbrojtjes civile për të minimizuar pasojat.
- Institucionet shtetërore në nivel rajonal e vendor duhet të përcaktojnë strukturën përkatëse (personin) për planifikimin, parandalimin dhe përballimin e EC, si dhe të shkëmbejnë informacionin e nevojshëm me bashkitë në lidhje me hartimin e Dokumenteve Strategjike në nivel vendor, si dhe për çështje të tjera në fushën e Mbrojtjes Civile.

- Vështirësi e pengesa në marrjen e informacionit nga bashkitë lidhur me përdorimin e fondit të kushtëzuar dhe realizmin e projekteve fituese në programin për EC dhe përmirësimin e kapaciteteve të tyre operacionale, etj.

Një drejtim tjetër shumë i rëndësishëm i punës tonë ka qënë dhe rritja e efektivitetit të punës të strukturave dhe të kapaciteteve operacionale të MC në nivel vendor, në veçanti sektorët e EC në bashki, për këtë:

- Është bashkëpunuar me bashkitë për vendosjen e strukturës së përhershme të EC, plotësimin me personelin e nevojshëm të sektorëve të EC dhe aftësimin e vazhdueshëm të tyre si struktura kryesore në fushën e MC (aktualisht Bashkia Korçë e Devoll është e pa kompletuar me personelin e nevojshëm).
- Janë zhvilluar disa takime pune të veçanta me sektorët e EC të bashkive, për rritjen e rolit dhe të përgjegjësisë së tyre në administrimin e EC.
- Janë zhvilluar takime pune të veçanta me sektorët e MZSH-së të bashkive lidhur me gatishmërinë e mjeteve të MZSH-së dhe të personelit për përballimin e situatave problematike të rënies së zjarreve.
- Kemi marrë takime me strukturat e ujitjes dhe të kullimit si dhe shërbimin pyjor në bashki me theks të veçantë koordinimin e punës dhe të veprimtarive me sektorin e EC në funksion të MC etj.
- Kemi marrë pjesë në takime pune, trajnimet dhe veprimet praktike që kryen nga grupet vullnetare, vrojtues-sinjalizues për njoftimin, izolimin e vatrave të zjarrit deri në ardhjen e kapaciteteve kryesore të bashkisë, veprimet e sektorëve të MZSH-së për fikjen e zjarrit në situata të ndryshme, etj.

#### Të ndryshme:

- Gjatë vitit 2024 ka funksionuar shume mirë njoftimi i hershëm për ndryshimet e kushteve meteorologjike nga ana e Shërbimit Meteorologjik Ushtarak (SHMU), IGJU dhe AKMC duke bërë paralajmërimin në mënyrë specifike mbi situatat e pritshme për përkeqësimin e motit dhe mbi zonat që mund të ndikojë, masat që duhen marrë, gatishmërinë e strukturave operacionale, etj.
- Janë përgatitur dhe dërguar bashkive të qarkut të Korçës, institucioneve, shtetërore në nivel rajonal e vendor udhëzime e shkresa të ndryshme në lidhje me organizimin e punës dhe marrjen e masave për njohjen dhe evidentimin e riskut, koordinimin e punës për administrimin sa më të mirë të emergjencave civile verore e dimërore, ngritjen dhe plotësimin e strukturave të EC, përdorimin me efektivitet të fondeve për EC, përgatitjen dhe dorëzimin brenda afateve ligjore të dokumentacionit për familjet që kanë pësuar fatkeqësi të ndryshme natyrore, etj.
- Në varësi të situatave dhe ngjarjeve të ndodhura në shkallë qarku është shkëmbyer informacioni i vazhdueshëm me AKMC për njohjen dhe zgjidhjen e problematikave të konstatuara, në veçanti për dy rastet e rënies së zjarreve në Bode-Gorë dhe Parkun Kombëtar Prespë .
- Kemi bashkëpunuar me ARRSH, Drejtorinë e Rajonit Qëndër-Lindje duke shkëmbyer informacionin e nevojshëm për problematika të ndryshme.

#### Puna me dosjet e familjeve që kanë pësuar dëme nga fatkeqësi natyrore:

- Është bashkëpunuar me AKMC lidhur me shlyerjen e detyrimeve për familjet që kanë pësuar fatkeqësi natyrore të ndryshme në veçanti ato të tërmetit të vitit 2019, si dhe për detyrimet e prapambetura.

- Në vazhdimësi është bashkëpunuar me strukturat e EC në bashki për përgatitjen dhe dërgimin në kohë të praktikave për familjet që kanë pësuar fatkeqësi të ndryshme për shlyerjen e detyrimeve financiare sipas afateve të përcaktuara në aktete ligjore e nënligjore për EC.

#### Puna me korrespondencën dhe informacionet:

Gjatë vitit 2024 janë trajtuar mbi shkresa, (informacione, kërkesa, kthim përgjigje, etj) nga të cilat 142 të marra dhe 30 të dërguara, me bashkitë, institucionet qendrore, rajonale dhe vendore etj.

Nga Sektori i PPECK është reflektuar një angazhim dhe predispozicion në ndjekjen dhe realizmin e detyrave të planifikuara dhe të situatave emergjente të krijuara. Specialistët e EC kanë dhënë ndihmën dhe kontributin e tyre duke mundësuar bashkëpunimin me strukturat e EC të bashkive për administrimin e EC, sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për domosdoshmërinë e ruajtjes së pyjeve, pronës private e publike nga zjarri, si dhe të situatave të krijuara nga fatkeqësi të ndryshme natyrore.

Krahas punës së bërë, jemi të vetëdijshëm pasi ka vend të përmirësohet puna për një mirëadministrim të problematikave që shfaqen në fushën e mbrojtjes civile në qarkun e Korçës.

Problematika kryesore për të cilën duhet të punojmë më shume për vitin 2025 dhe që kërkojmë mbështetje, mbetet rritja e bashkëpunimit midis strukturave të bashkive, në veçanti në fushën e mbrojtjes civile, dhe të bashkive me institucionin tonë, problem i cili ka vend të përmirësohet.

Vështirësi e probleme reflektohen në shlyerjen e detyrimeve për familjet që pësojnë fatkeqësi të ndryshme natyrore, të cilat vazhdojnë të trajtohen sipas Vendimit Nr.329, datë 27.12.2012 e KM, etj.

#### **VII: Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse:**

Drejtimet kryesore të punës të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të Institucionit të Prefektit për vitit 2024 kanë qenë:

- Administrimi i Programit Buxhetor të Institucionit të Prefektit.
- Ndjekja dhe rakordimi i të ardhurave jo tatimore dhe shpenzimeve të krijuara nga institucioni.
- Plotësimi i nevojave ekonomike të Institucionit nëpërmjet prokurimit të fondeve.
- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore të Institucionit.
- Marrëdhëniet me publikun dhe arshivimi i dokumentacionit

#### Administrimi i Programit Buxhetor të Institucionit të Prefektit

Për arritjen e objektivave Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka zbatuar legjislacionin në fuqi në fushën e financave, në fushën e shërbimit civil, marrëdhënieve me publikun dhe informimin publik.

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, që në fillim të vitit 2024, u angazhua në detajimin e fondeve buxhetore të akorduara për vitin 2024, duke paraqitur sa më saktë nevojat e Institucionit të Prefektit për të dy programet buxhetore, Aparat dhe Gjendje Civile, në nivel titull, kapitull, artikull e nënartikull. Realizimi i regjistrimit të prokurimeve publike u hartua në kohë dhe u zbatuar me korektësi për funksionimin normal të institucionit dhe strukturave të tjera.

Prioritet i Sektorit të Financës ka qenë garantimi, para miratimit të urdhërave me karakter financiar, i zbatimit të

ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe respektimit të parimeve të efijçencës dhe efektivitetit të shpenzimeve.

Realizimi në % i buxhetit për vitin 2024 është si më poshtë Aparat, Gjendje Civile:

NR	Emertimi i shpenzimit	Artikulli	Aparati	Gj. civile
1	Paga	600	97%	99%
2	Sig Shoqërore	601	97%	96%
3	Shpenzime operative	602	83%	100%
4	Shpenz. për buxh. fam. e pagesë kalimtare	606	99.9%	0
5	Shpenzime për investime	231	96.5%	0

Emërtimi	Plani 12 mujor	Pakësim/shtim	Plani 12 mujor me ndryshime	Fakti 12 mujor	Fonde të kthyera në buxhetin e shtetit	Realizimi 12 mujor 2024	Realizimi 2023
Aparati-							
Paga, shpërblime dhe te tj. shp. personeli	32.950.000	+2.550.000	35.500.000	34.570149	928.851	97%	99%
Kontribute për sigurime shoqërore, shën.	5.454.000	+450.000	5.904.000	5.698.043	205.957	97%	99%
Mallra dhe shërbime të tjera	8.362.000		8.363.000	6.932.489	1.430.511	83%	80%
Shpenzime për investime	1.000.000		1.000.000	964.589	35.411	96.5%	0
Shpenzime për buxh.famil.ind	130.000	+273.000	403.000	402.800	200	99.9%	50%
Gj Civile							
Paga, shpërblime dhe te tj. shp. person	4.408.000	+700.000	5.108.000	5.069.540	38.460	99%	98%
Kontribute për sigurime shoqërore, shën.	736.000	+150.000	886.000	846.612	39.388	96%	93%
Mallra dhe shërbime të tjera	0	18 000	18.000	18.000	0	100%	10%

Referuar tabelës të mësipërme, realizimi i buxhetit për programin e Aparatit sipas artikujve të shpenzimeve ka qenë:

Artikulli 600 (Paga) është realizuar në masën 97%, duke pasur parasysh edhe vendin vakant në institucion.

Artikulli 601 (Sig.shoq.dhe shendetësore) është realizuar në masën 99 %, edhe kjo ka të bëjë me realizimin e fondit të pagave dhe plotësimin e organikës së Aparatit.



Artikulli 602 (shpenzime operative) është realizuar në masën 83 % për arsye si më poshtë:

Kursimi në shpenzimet e energjisë elektrike është një nga shkaqet e këtij realizimi. Këtë vit përfundoi edhe marrëveshja për ndarjen e pagesës së faturës së energjisë në bazë të përqindjes së përcaktuar, me institucionet e tjera që ndodhen në të njëjtën godinë. Institucionet vendosën sahat të veçantë.

Gjatë vitit 2024 nuk u zhvillua asnjë procedurë prokurimi për mirëmbajtjen e automjetit Mitsubishi me targa AA 505 DL, pasi mjeti kishte probleme me motorin (harxhim vaji) dhe vlera për riparimin e tij krijon kosto të konsiderueshme duke marrë parasysh që vlera e mbetur e këtij mjeti sipas regjistrit të aktiveve është 0.

Artikulli 606 (Shpenzime për buxhetet familjare e pagesat kalimtare) fondet për këtë artikull janë realizuar në masën 99.9 %, sipas nevojave të verifikuara të institucionit.

Fondet në artikullin 231(investime), shërbyen për tu pajisur me kondicioner pjesa më e madhe e ambjenteve të prefekturës.

Në lidhje me realizimin e Buxhetit të Gjendjes Civile, vlen të theksohet se çelja e fondeve për artikullin 602 u bë e dedikuar për lidhjen e librave të arkivave të Gjendjes Civile, në kapitulli 01, Programi 01170. Vlera e çelur e fondit ishte se vlera e realizimit të këtij shërbimi.

Ndjekja dhe rakordimi i të ardhurave jo tatimore

Të ardhurat e arkëtuara nga institucioni për vitin 2024 janë 0 lekë.

Të ardhurat jo tatimore nga aktiviteti i gjendjes Civile në Prefekturë dhe Nënprefektura, të cilat derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit, janë 0 lekë sepse që pas mbylljes së sporteleve të gjendjes civile, në datë 1 tetor 2023, nuk ka më tërheqje të pullave nga këto sportele e për rrjedhojë edhe arketime.

Është kryer rregullisht, brenda afateve të përcaktuara në udhëzimet për zbatimin e buxhetit, rakordimi me degën e thesarit të rrethit për të ardhurat dhe shpenzimet mujore dhe progresive për çdo zë të shpenzimeve, për të dy programet buxhetore. Brenda datës 05 të çdo muaji është raportuar në Drejtorinë e Financës së Ministrisë së Brendshme dhe tek Drejtuesi i Programit Buxhetor, informacioni për të dhënat operative për realizimin e zërave kryesore të buxhetit.

Është zbatuar ligjëshmëria në lidhje me hartimin e listpagesave të punonjësve për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore, janë respektuar afatet për deklarimin online të detyrimeve për sigurime shoqërore e shëndetësore dhe të tatimit mbi të ardhurat personale.

Është ndjekur kryerja e inventareve të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe mallrave në magazinë, duke kërkuar nga komisionet e inventarizimeve saktësi në evidentimin dhe respektimin e afateve.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9228, datë 30.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, janë regjistruar të gjitha transaksionet në mënyrë kronologjike, mbështetur në dokumentat bazë, në librat e llogarive, në ditarët analitik, në librat ndihmës dhe janë përpiluar pasqyrat financiare të institucionit për vitin 2024. Është zbatuar afati për dorëzimin e tyre në Degën e Thesarit dhe në Drejtorinë e Financës në Ministrinë e Brendshme.

### Plotesimi i nevojave ekonomike të Institucionit

Nga ana e SFSHM-së janë marrë masat për plotësimin e kërkesave të sektorëve si me bazë materiale, mirëmbajtje ambjentesh, furnizimi me karburante për mjetet e institucionit, ashtu edhe me pjesë këmbimi.

Gjithashtu janë marrë masat për përmbushjen e nevojave dhe përmirësimin e kushteve të punës në Institucion, me mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike, mirëmbajtjen e godinave, detergjentë pastrimi, meremetim difektesh etj, për të cilat janë shfrytëzuar procedurat përkatëse të tenderimit sipas legjislacionit në fuqi.

### Menaxhimi i Burimeve njerëzore të Institucionit

Gjatë vitit 2024 menaxhimi i burimeve njerëzore vazhdon të kryet në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Janë pasqyruar ndryshimet në organikë, duke plotësuar dosjet e personelit për punonjësit. Është përpiluar e ndjekur ritmikisht grafiku i lejave të punonjësve sipas muajve përkatës, si dhe zbatimimi i tij sipas afateve të miratuara. Nga specialistja e burimeve njerëzore janë hedhur dhe përditësuar të dhënat e punonjësve në regjistrin elektronik të institucionit.

Në fillim të vitit 2024 në Institucionin e Prefektit ka patur 3 (tre) pozicione vakante:

1. Përgjegjës në Sektorin e Zhvillimit Urban
2. Specialist në Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave
3. Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara.

Nga të cilat 2 (dy) pozicionet "specialist" janë plotësuar nëpërmjet procedurave të shërbimit civil, nga DAP (nga lista fituese).

Pozicioni Përgjegjës në Sektorin e Zhvillimit Urban, aktualisht është në procedurë me shpalljen nr.6613, ka përfunduar konkurrimin nëpërmjet procedurës "Ngritje në detyrë" dhe pritet shpallja e rezultateve dhe fituesit nga DAP.

Në zbatim të Urdhërit nr.120 datë 17.7.2024 të Kryeministrit “Për një ndryshim në Urdhërin nr.9 datë 12.01.2016 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institucionit të Prefektit të Qarkut të Korçës”, me kerkese nr.716 prot, datë 06.08.2024 "Kërkesë për ngritjen e komisionit të ristrukturimit" të Sekretarit të Përgjithshëm drejtuar D.A.P-it, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit me Urdhër Nr.535, date 15.08.2024 të Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike. Komisioni i Ristrukturimit, pasi mori në shqyrtim strukturën dhe organikën ekzistuese si dhe organikën e re të Administratës të Prefektit të Qarkut Korçe, si dhe vlerësoi mundësitë e transferimit të perhershëm të secilit prej nëpunësve, në datën 06.09.2024, dërgoi aktet e transferimit për shkak të ristrukturimit të institucionit, për secilin nga nëpunësit e Prefekturës Korçë.

### Marrëdhëniet me publikun dhe arshivimi i dokumentacionit

Është ndjekur në mënyrë kronologjike korrespondenca si për të ardhurat në adresë të Institucionit ashtu edhe ato të dala, duke kthyer përgjigje në afatet e parashikuara. Në të njëjtën kohë, specialistja e arkiv-protokoll kryen edhe funksionin e koordinatorit për të drejtën e informimit, konform ligjit “Për të drejtën e informimit”.

Gjatë këtij viti është bërë përpunimi dhe përgatitja e dokumentave të përkohshëm të shtatë viteve për asgjësim, është marrë konfirmimi nga drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe gjatë vitit 2025 do të kryhet asgjësimi I këtij dokumentacioni në një nga format që parashikojnë dispozitat ligjore “Për Arkivat”.

Problematika të zgjidhura gjatë vitit 2024:

1. Regjistrimi i pronave të institucionit dhe pajisja me certifikatë pronësie përfundoi brenda vitit 2024. Për arsye të rikonfirmimit të planeve të rilevimit nga ASHK-të e rretheve dhe rihartimi i planeve të rilevimit, ky proces zgjati në kohë gjatë gjithë vitit.
2. U bë shpëputja me sahat me vete i energjisë elektrike të institucioneve të tjera me të cilat ndajmë ambjentet e godinës ku ushtrojmë aktivitetin.
3. Gjatë vitit, pas komunikimeve të vazhdueshme edhe me AKSH-in, u bë e mundur riaktivizimi i faqes zyrtare të institucionit dhe u përditësua në faqen zyrtare i gjithë informacioni i kërkuar në zbatim të programit të transparencës dhe ligjit “Për të drejtën e informimit”.

Problematika që kërkojnë vëmendje për vitin 2025:

Gjatë vitit 2024 nuk u zhvillua asnjë procedurë prokurimi për mirmbajtjen e automjetit Mitsubishi me targa AA 505 DL, pasi mjete ka probleme me motorin (harxhim vaji) dhe vlera për zëvendësimin e tij krijon kosto të konsiderueshme duke marrë parasysh që vlera e mbetur e këtij mjete sipas regjistrimit të aktiveve është 0. Në fund të këtij viti është parë e arsyeshme nga Prefekti i Qarkut që të bëhet zëvendësimi i këtij mjete me një mjet tjetër me qera, për nevoja të institucionit.

Gjatë vitit u pajisën me kondicioner pjesa më e madhe e ambjenteve të prefekturës, por ngelën për tu pajisur edhe tre zyra si dhe zëvendësim i paisjeve të vjetra kompjuterike/elektronike, të cilat do të realizohen me celjen e fondeve në artikullin 231, gjatë vitit 2025.

Gjithashtu, lind si nevojë imediate dhe e përsëritur shtesë në organikë e një punonjësi IT, si për mirëmbajtjen e rrjetit kompjuterik ashtu edhe për mirmbajtjen e faqes zyrtare.

**VIII: Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara:**

Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, ka si objekt të punës së tij:

- Garantimin cilësor të shërbimeve të shtetasve, duke siguruar nga institucionet qendrore në nivel vendor marrjen e masave për plotësimin e detyrave në funksion të tyre.
- Garantimin e shërbimeve të nevojshme në fushën e shërbimeve publike, shëndetit publik, higjenës dhe arsimit, duke bashkërenduar punën me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për realizimin e këtyre shërbimeve.
- Përmirësimin e jetesës së grupeve të marginalizuara dhe krijimin e mundësive për riintegrimin social të tyre, duke bashkëpunuar me OJF-të e rajonit.
- Monitorimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor, si dhe të këtyre me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për plotësimin e detyrave.

- Marrjen e masave për garantimin e shërbimeve cilësore ndaj shtetasve nga institucionet qendrore në nivel vendor dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- Verifikimin e ligjshmërisë së akteve të miratuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore me karakter financiar, social-ekonomik.
- Sigurimin për përmbushjen e detyrave në zbatim të Funksioneve të Deleguara pranë Institucionit të Prefektit nga Institucionet e Qeverisjes Qendrore.

#### Konfirmimet e vendimeve të Këshillave Bashkiake:

- Në bashkëpunim me Sektorin Juridik janë verifikuar Vendimet e Këshillave Bashkiakë dhe të Këshillit të Qarkut lidhur me miratimin e buxheteve, ndryshimet në buxhet, zhvillimin ekonomik, investimet si dhe vendime të tjera me karakter ekonomik – financiar. Gjatë vitit 2024 janë verifikuar gjithsej 134 vendime.

#### Trajtimi i problematikave të paraqitura në S.M.K.V.F.D:

- Janë shqyrtuar ankesat e qytetarëve lidhur me mospërfitimin e ndihmës ekonomike, ndërprerje të KEMP, për të cilat ju është kthyer përgjigje lidhur me arsyet e mospërfitimit ose ju janë dhënë udhëzimet e duhura mbi procedurat që duhet të ndjekin për përfitimin e saj;
- Janë trajtuar të gjitha ankesat e paraqitura në institucion apo të bëra të njohura nga media, lidhur me shërbimet publike (kanalizimet, uji i pijshëm, energjia, transporti, ndotja e mjedisit, shqetësime lidhur me turizmin, etj) si dhe çështjet sociale (arsimi, shëndetësia, strehim, përfitimet e pensioneve, ndihma ushqimore, etj);
- Janë kryer verifikime të dokumentave të gjendjes civile të ardhura nga Konsullata Greke;
- Janë asistuar me ndihmë dhe ju janë dhënë sqarimet përkatëse qytetarëve të cilët hasin vështirësi për aplikimet on line në e-albania (çertifikata, vërtetim vjetërsie në punë, nxjerrje pensioni, etj);

#### Detyra teknike të kryera:

- Janë legalizuar dokumentat e lëshuara fizikisht nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, mesatarisht 8-15 dokumenta në ditë;
- Sektori ka trajtuar gjithsej 108 shkresa për probleme të ndryshme, të cilat u janë drejtuar institucioneve përkatëse, NJVV-ve dhe më pas ju është kthyer përgjigje shtetasve;
- Përpunimi dhe vlerësimi i informacioneve mujore të degëve territoriale të ardhura nga Institucionet dhe Organet e Vetëqeverisjes Vendore;
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të buxheteve vjetore, projekt buxhetet afatmesme, realizimet e të ardhurave dhe strukturat organike;
- Të gjithë specialistët e Sektorit kanë marrë pjesë dhe kanë kryer të gjitha detyrat e përcaktuara për komisionet e ngritura me Urdhër të Prefektit të Qarkut (inventarizimi, KVO, konstatim dëmi e marrje në dorëzim, etj);

- Mbledhje dhe përpunim informacioni për realizimin e të ardhurave në Bashkitë e Qarkut Korçë dhe Këshillin e Qarkut Korçë. Totali i realizimit të të ardhurave në Qarkun Korçë për vitin 2024 është: 1 596 332 ALL;

Tab. 1 Evidenca e realizimit të të ardhurave tek NJ.V.V. e qarkut Korçë Janar - Dhjetor 2024 (në 000/lekë)

NR.	PERIUDHA	TOTALI I TE ARDHURAVE		TE ARDHURA TATIMORE		TE ARDHURA JO TATIMORE	
		PLAN	FAKT	PLAN	FAKT	PLAN	FAKT
1	Këshilli i Qarkut	94,737	24,889	0	0	94,737	24,889
2	Bashkia Korçë	1,246,213	760,425	752,663	376,268	493,550	384,157
3	Bashkia Maliq	300,524	163,640	134,095	91,996	166,429	71,644
4	Bashkia Pustec	8,000	4,718	4,286	1,947	3,714	2,771
5	Bashkia Pogradec	665,004	436,701	553,680	264,096	111,324	172,605
6	Bashkia Kolonjë	84,645	60,945	19,683	21,378	64,962	39,567
7	Bashkia Devoll	197,092	145,014	100,087	69,794	97,005	75,220
	TOTALI	2,596,215	1,596,332	1,564,494	825,479	1,031,721	770,853

### Aktivitetet e SMK VFD

#### Shërbime publike

- Është mbledhur dhe përpunuar informacion nga bashkitë e qarkut për Vitin e Pyjeve 2024, initiative e cila kishte si qëllim shtimin e sipërfaqeve pyjore;
- Është zhvilluar takim me përfaqësues të Bashkisë Korçë, DVP Korçë dhe shoferë të transportit publik, lidhur me shqetësimin e tyre për konkurrencën e pandershme.

#### Arsim

- Praktikant profesionale të studentëve të Universitetit “Fan S. Noli”;
- Takim me studentë të universitetit “Fan S.Noli”, lidhur me problematikat për kartën e studentit;
- Takim me përgjegjës të ZA dhe Drejtorive Mbeshtetëse të bashkive të qarkut lidhur me problematikat e hasura në fillimin e vitit të ri shkollor 2023 - 2024.

#### Çështje sociale

- U zhvillua takim me drejtuesit e ZVA, DVP dhe DRAP, ku u diskutua Paketa e sigurisë në shkolla, monitorimet e kryera gjatë vitit 2023 si dhe plani i vitit 2024.
- Janë zhvilluar 10 takime informuese dhe ndërgjegjësuese në shkolla në kuadër të muajit Antitrafik, ku u diskutua lidhur me zbatimin e masave të Planit Kombëtar të Veprimtimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave;
- Gjatë muajit Tetor janë zhvilluar gjithashtu aktivitete sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese me fëmijë të shkollave 9-vjeçare, për çështje të trafikimit të qënieve njerëzore;
- Sektori ka marrë pjesë në 5 mbledhje të zhvilluara në Bashkitë e Qarkut lidhur me diskutimin e shifrave të rasteve të dhunës me bazë gjinore në familje MKR (Mekanizmi Koordinues I Referimit të Rasteve);

- Sektori organizoi një takim në ambientet e Prefekturës në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Korçë;
- Sektori ka marrë pjesë në takimin me nënkryetarët e bashkive të qarkut për infrastrukturën e ujitje-kullimit, sigurinë ushqimore dhe transumancën;
- Sektori ka kryer verifikime në vend të rasteve specifike, nëpërmjet Grupeve të Punës;
- Sektori ka marrë pjesë në takimin e zhvilluar nga Universiteti Fan S. Noli për “Akademinë Verore”;
- Sektori ka marrë pjesë në Panairin e Punës, zhvilluar nga Universiteti Fan S. Noli në bashkëpunim me institucionet e qarkut;
- Sektori mori pjesë në trajnimin për strukturat vendore të migracionit dhe diasporës, pjesë e projektit MEG;
- Sektori ka marrë pjesë në trajnimin për Higjienën Kibernetike, Inteligjencën me burim të hapur (OSINT) dhe inxhinierinë sociale;
- Sektori ka marrë pjesë në Tryezen e rrumbullakët të rrjetit POP, ku u diskutua mbi rezultatet e raportit “Transparenca dhe Përgjegjësia në nivel vendor - Vlerësimi i proceseve të Konsultimit Publik për Bashkinë Korçë”;
- Sektori ka marrë pjesë në çeljen e fushatës "16 ditë të aktivizimit me bazë gjinore”;
- Sektori ka marrë pjesë në trajnimin "Zbatimi i sistemeve të sigurisë ushqimore në prodhimin e fruta perimeve”;
- Sektori ka marrë pjesë në takimin e zhvilluar nga GIZ dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për prezantimin e Strtategjisë së re të turizmit 2024 – 2030;
- Sektori ka marrë pjesë në trajnimin "Gruaja, Paqja dhe Siguria", trajnim për zbatimin e rezolutës 1325 të Keshillit të Sigurimit të OKB;
- Sektori ka marrë pjesë në forumin konsultativ dhe trajnimin "Mbrojtja e grupeve vulnerabël brenda lëvizjeve migratore”.

Projekt Propozimet për financim nga donatorët e huaj në programin INTERREG VI-A IPA Greqi-Shqipëri 2021-2027.

Sektori pasi ka marrë pjesë në Info Day në Janinë dhe Vlorë, për informacion rreth projekteve të programit IPA 2021-2027 ka plotësuar dokumentat për aplikimet në thirrjen e parë të Projekteve IPA CrossBorder Greece-Albania 2021-2027, si më poshtë vijon:

1. *“A Slow Tour”* - është një projekt që ka si qëllim shfrytëzimin e pikave të forta të sektorëve të bujqësisë dhe turizmit në zonën ndërkufitare, të cilat jo vetëm tradicionalisht kanë qenë një nga pikat e forta të zonës, por për më tepër tregojnë sot një dinamikë të madh drejt një mënyre më të qëndrueshme turizmi.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të identifikojë, mbështesë dhe përmirësojë atraktivitetin dhe promovimin e rajonit ndërkufitar dhe të rrisë punësimin në turizmin e qëndrueshëm nëpërmjet përdorimit të zgjeruar dhe të qëndrueshëm të potencialeve të tyre turistike. *“A Slow Tour”* synon zhvillimin, vlerësimin, përmirësimin dhe promovimin e produkteve konkrete turistike të lidhura me bujqësinë, të cilat do të jenë konkurrese, por jetike dhe të adaptueshme në të njëjtën kohë në rajonin ndërkufitar. Institucioni është njoftuar për kalimin e fazës së parë të projektit dhe është në pritje të ndjekjes së procedurave në vazhdim. **(Buxhet: 1.500.000,00€)**

2. *“Civil Pro”* - ka si qëllim parandalimin e fatkeqësive natyrore si përmbytjet, zjarret dhe tërmetet, të përkeqësuar nga ndryshimet klimatike. Të dy vendet përballen me ngjarje të ngjashme ekstreme të motit me ndikim shkatërrues si në mjedisin natyror ashtu edhe në atë njerëzor. Madhësia e këtyre humbjeve ekonomike, strukturore dhe njerëzore varet nga faktorë të tillë si aftësia e popullsisë për t'i bërë ballë ose për t'i rezistuar fatkeqësisë, niveli i saj i qëndrueshmërisë, planifikimi i duhur dhe ekzistenca e sistemeve të fuqishme të menaxhimit të emergjencave. **(Buxhet: 1.500.000,00€)**

3. *“Developing and Implementing Smart and Sustainable Integrated Wildfire Management System in the Cross-border Area” (DISSIWMS)* – Ka objektiv zhvillimin e përbashkët dhe inovativ të sistemit të menaxhimit për mbrojtjen ndërkufitare të mjedisit, monitorimin dhe njohjen e hershme të rrezikut dhe parandalimin nga zjarret.

4. *“Firesence”* - Zona ndërkufitare Greqi-Shqipëri (e pasur me biodiversitet) përballlet me rreziqe të konsiderueshme zjarresh për shkak të klimës mesdhetare, me verë të nxehtë dhe të thatë dhe stuhi të shpeshta. Për të adresuar këto sfida, projekti FIRESENSE synon të përmirësojë aftësitë e parandalimit të zjarreve dhe zbulimit të hershëm përmes teknologjive inovative dhe bashkëpunimit ndërkufitar.

Qëllimi kryesor i projektit është të rritë aftësitë e parandalimit të zjarreve dhe zbulimit të hershëm të tyre nëpërmjet zbatimit të teknologjive të avancuara, bashkëpunimit ndërkufitar dhe angazhimit të komunitetit, nëpërmjet sistemeve për të arritur objektivat kryesore:

- Paralajmërimin dhe zbulimin e hershëm;
- Gatishmërinë dhe planifikimin përmes teknologjive AI (inteligjenca artificiale);
- Bashkëpunimi ndërkufitar;
- Angazhimi i komunitetit dhe ngritja e kapaciteteve.

5. *“MATE”* - Qëllimi i projektit është të promovojë qasje inovative për të trajtuar ndikimin e ndryshimeve klimatike në aktivitetet bujqësore në zonën ndërkufitare Greqi - Shqipëri, duke mbështetur fermerët vendas për të mbajtur të ardhurat e tyre. Projekti synon të aplikojë bujqësi miqësore me klimën dhe prodhimin e ushqimeve cilësore. Projekti nuk e ka kaluar fazën e tij të parë dhe është në proces ankimimi.

6. *“Smart & Safe Cognitive Environment and Representation Modelling” S2CE* – është një projekt kërkimor dhe ka për qëllim të kontribuojë në uljen e rreziqeve në lidhje me infrastrukturën kritike dhe ekosistemet kibernetike duke përcaktuar modele, metodologji dhe mjete për të mbështetur ruajtjen e një shoqërie elastike. Projekti synon të përmirësojë qëndrueshmërinë e infrastrukturave kritike dhe sistemeve urbane.

Ai adreson rreziqe të ndryshme, qofshin ato të shkaktuara nga njeriu apo natyra, duke zhvilluar mjete dhe metoda të avancuara për monitorimin, vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e emergjencave. Projekti propozon integrimin e Sistemeve të Informacionit Gjeografik (GIS) dhe Modelimit të Informacionit të Ndërtesave (BIM) për të krijuar një qasje të unifikuar për menaxhimin e të dhënave në shkallë të ndryshme. Fokusi i projektit është në parashikimin e skenarëve të rrezikut, menaxhimin e qëndrueshmërisë dhe përshtatjen ndaj ngjarjeve të paparashikuara.

Me anë të këtyre inovacioneve, projekti synon të krijojë një ekosistem urban më të sigurt, më të adaptueshëm dhe më të mbrojtur. **(Buxhet: 350.000,00 €).**

7. *SNOWpaths* - është një nismë pioniere e krijuar për të zhbllokuar potencialin e plotë të zonës ndërkufitare midis Greqisë dhe Shqipërisë duke krijuar turizëm të qëndrueshëm dimëror. Ky projekt ka për qëllim të zbulojë mundësitë e pashfrytëzuara të paraqitura nga peizazhet piktoreske të rajonit dhe trashëgimia e pasur kulturore, duke synuar të krijojë një destinacion gjatë gjithë vitit. Në zemër të *SNOWpaths* qëndron zhvillimi i shtigjeve miqësore me mjedisin për ski që integrohen pa probleme me natyrën, duke ofruar përvoja emocionuese për vizitorët. Këto shtigje do të projektohen me kujdes për të minimizuar ndikimin ekologjik, duke përdorur teknika inovative për menaxhimi i shpateve, ruajtjen e borës dhe ruajtjen e jetës së egër.

Përveç shtigjeve fizike të skijimit, *SNOWpaths* do të prezantojë përvojat virtuale më të fundit (VR) që lejojnë përdoruesit të eksplorojnë peizazhet e mbuluara me dëborë të zonës Greqi-Shqipëri nga kudo në botë. Duke përdorur teknologjinë VR, projekti synon të tërheqë një audiencë globale të adhuruesve të dimrit, duke i frymëzuar ata të vizitojnë rajonin.

SMKVFD organizon dhe ndjek zhvillimin e disa komiteteve rajonale dhe Task Force:

#### 1. Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 2 takime të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, për sezonin veror dhe atë dimëror dhe në këto takime problematikat kryesore të trajhuara ishin: infrastruktura dhe sinjalistika rrugore, mirëmbajtja e qendrave të Trashëgimisë Kulturore, siguria ushqimore, kontrollet sistematike të cilësisë së ushqimit tek subjektet private, çështjet e sigurisë në hotele (pa dalje emergjence në raste zjarresh), menaxhimi i mirë i mbetjeve në zonat turistike, analizat e ujit në Pogradec, shtigjet për turizmin malor, garantimi i rendit dhe qetësisë publike, parandalimi i veprimtarive kriminale në të gjitha zonat turistike të qarkut, furnizimi pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, etj. Gjatë vitit 2024:

- Janë respektuar të gjithë rregullat për hapësirat publike;
- Janë përcaktuar vendparkimet dhe sinjalistikat për mjetet lundruese;
- Janë vendosur bovat përgjatë vijës liqenore;
- Janë vendosur roje bregdetare në të gjitha kullat e vrojtimit.

Synimi kryesor në fushën e turizmit mbetet rritja e fluksit të turistëve, për të realizuar objektivin në një periudhë afatmesme për arritjen e shifrës prej 1 milionë turistë vendas e të huaj që e vizitojnë qarkun tonë në një vit.

Numri i turistëve për qarkun Korce, viti 2024												
Muaji/Bashkia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Totali
Korce	26000	26000	26000	26000	26000	25000	25000	25000	25000	25000	25000	280000
Pogradec	3948	3948	3948	6743	6042	7344	26676	37150	15477	9886	7608	128770
Devoll	5500	5500	5500	5500	5500	5500	5500	5648	5500	5500	5500	60648
Kolonje	800	850	850	1900	1950	1950	4000	4000	4000	3100	3100	26500
Maliq	1300	1300	1300	1300	1300	1000	1000	1000	1000	1000	1000	12500
Pustec	3165	3291	4088	7000	9150	9250	11180	12480	10450	10430	6980	87464
												595882

Tab. 3 Numri i turistëve të qarkut Korçë – 2024



- Sektori ka raportuar informacionin javor, mbledhur nga institucionet anëtare të Task Force gjatë gjithë sezonit turistik veror, i cili është dërguar në Ministri;
- Sipas kërkesave, janë dërguar në ministri kalendaret e festive lokale për çdo bashki të qarkut;
- Miratimi i Hartës së Përgjithshme për Plazhet e Lejuara në Bashkinë Pogradec – detyrë për Bashkinë Pogradec, e cila është realizuar me sukses. Harta përmban: stacionet e plazhit, hapësirat e plazhit public, vendodhja e kullave dhe pikave të vrojtimit, zona e çadrave, zona e shërbimeve, hapësira ujore për notim (e kufizuar me bova) dhe vendbazimet e mjeteve lundruese (zona rekreative).

## 2. Komiteti Rajonal Antitrafik

Komiteti Rajonal Antitrafik dhe tryezat teknike të tij, kanë qëllim rritjen e bashkëpunimit me të gjithë strukturat në luftën kundër trafikimit të njerëzve në gjithë Rajonin e Korçës. Për këtë arsye, Komiteti Rajonal ka zhvilluar gjatë këtij viti 2 takime me anëtarë të KRAT dhe 2 takime me anëtarë të TTA. Diskutimet kryesore në KRAT-et e zhvilluara gjatë vitit 2024 kanë qenë propozimet dhe sugjerimet për urdhrin e ri që do të hartohet, evidentimi i problematikave të hasura gjatë zbatimit të urdhrin ekzistues të KRAT, propozimet dhe sugjerimet për urdhrin e ri si dhe përshtatja e qasjeve të reja për mirëfunksionimin e tij. (lidhur me përpilimin e Urdhërave të KRAT-eve, UNICEF ka punësuar një eksperte të jashtme, e cila mori pjesë në takimin e KRAT, ku theksoi se se qeveria shqiptare është duke bërë një reformë të përgjithshme në lidhje me migracionin dhe antitrafikun).

Një fenomen i ri për Shqipërinë, i cili ka prekur edhe qarkun Korçë është evidentimi i fëmijëve të huaj të pashoqëruar në zonat ndërkuftare (Kapshticë). Ministria e Brendshme ka njoftuar ndërtimin e një qendre për pritjen e fëmijëve të pashoqëruar brenda vitit 2025, me kapacitet 25-30 shtretër. Ndërsa, për shtetasit azilkërkues që vijnë bashkë me familjet e tyre, funksionon qendra pritëse në Babru, me kushte optimale jetese, duke përfshirë edhe shërbimet e infermierisë, qendrës paraspitalore, psikologjisë, etj.

Gjatë vitit 2024 në qarkun Korçë, nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, janë evidentuar 4 raste si viktime trafikimi. Kjo drejtori ngriti problemin e mungesës së një buxheti të specifikuar për këto grupe individësh gjatë procesit që ata qëndrojnë në intervistim.

## 3. Task Force Paketa e Sigurisë në Shkolla

Pas prezantimit të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Paketës së Sigurisë në Shkolla, gjatë vitit 2024 në kuadër të “Paketës së Sigurisë në Shkolla”, si një plan masash parandaluese dhe ndëshkuese me qëllim garantimin e sigurisë dhe parandalimin e kriminalitetit në mjediset e shkollave, janë kryer 31 monitorime në të gjithë shkollat e qarkut. Qëllimet e kësaj Task Force janë:

- Përcaktimi i perimetrit të sigurisë (124/156 shkolla e kanë të përcaktuar);
- Vendosja e sinjalistikës së plotë rrugore pranë çdo institucioni arsimor (nga 47/156 shkolla kanë sinjalistikë rrugore);
- Vendosja e kamerave të sigurisë në gjithë perimetrin e sigurisë në shkolla (51/156 shkolla kanë kamera sigurie);
- Vendosja e pajisjeve për shuarjen e zjarrit (117/156 shkolla kanë pajisje);
- Kontrollin e kushteve të sigurisë ushqimore (AKU 48 kontrolle);

- Kontrollin dhe prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme me qëllim lirim të hapësirave publike në perimetrin e sigurisë së shkollave (IKMT 72 kontrolle).

#### 4. Komiteti Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

Ky komitet është ngritur me qëllim identifikimin dhe referimin e rasteve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm (individët apo grupet vulnerabël në rrezik radikalizmi apo të radikalizuar), ndjekjen e të gjitha veprimeve, masave dhe aktorëve (shtetërorë ose jo shtetërorë) të përfshirë në parandalimin e radikalizmit. Objektivat kryesore të Komitetit janë:

- Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe proceset e rehabilitimit, ri integrimit dhe risocializimit të personave të kthyer nga zonat e luftës, në nivel qarku, pranë Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm;
- Komiteti shërben si urë lidhëse për trajtimin e nevojave sociale dhe ekonomike më të gjera të rasteve të identifikuara në rrezik radikalizmi apo të radikalizuara në qark.

Komiteti gjatë vitit 2024 ka zhvilluar dy takime me anëtarët apo përfaqësuesit e tyre dhe anëtarët e Sekretariatit Teknik:

- Në takimin e parë janë prezantuar të gjithë anëtarët, janë njohur me Rregulloren, kanë rënë dakort dhe e kanë nënshkruar atë. Ata janë njohur edhe me planin e punës për vitin 2024, për të cilin kanë të drejtë të propozojnë strategji konkrete për adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm si dhe rehabilitimin e të riadhesuarave nga zonat e konfliktit.
- Në takimin e dytë të Komitetit me pjesëmarrje edhe të drejtorit të Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, anëtarët raportuan se përgjatë vitit 2024 nuk ka patur raste të reja të evidentuara.

Në qarkun Korçë janë evidentuar dy hot spot-e (zona të nxehta), në Devoll dhe Pogradec, të cilat kanë qenë në vëmendje të vazhdueshme nga ana e të gjitha institucioneve dhe janë dy raste të personave të radikalizuar, të dy të raportuar nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë. Të dy personat janë nën vëzhgim dhe kontroll nga ana e stafëve të institucionit dhe trajtohen specifikisht me plan masash të veçantë.

#### 5. Task Force e Luftës Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit

Kjo Task Force ka funksionuar në kuadër të luftës së vazhdueshme kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit. Për funksionimin e saj Prefekti i Qarkut ka nxjerrë Urdhërin Nr. 14, dt. 09/02/2024 për “Ngritjen e grupit Task-Force për realizimin, koordinimin dhe bashkëveprimin efektiv në nivel qarku, mbi zbatimin e detyrimeve të parashikuara në planin e veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, 2023 - 2025”.

Gjatë vitit 2024, në zbatim të urdhërave e udhëzimeve përkatëse, janë zhvilluar 2 (dy) takime me anëtarët e Task Force dhe në kuadër të saj gjatë vitit 2024 janë ushtruar kontrolle të rregullta të territorit nga Komisaritet e Policisë Korçë, Pogradec, Devoll, Kolonjë dhe Maliq, gjatë të cilave janë evidentuar 75 vepra penale në fushën e narkotikëve (67 prodhim dhe shitja e narkotikëve, 7 trafikimi i narkotikëve, 1 të tjera). Janë zbuluar 74 raste me 132 autorë, nga të cilët 41 të arrestuar, 19 të ndaluar, 67 ndjekur në gjendje të lirë dhe 5 shpallur në kërkim.

Është kapur mbi 404 kg lëndë narkotike cannabis sativa dhe sasi e konsiderueshme kokaine e heroine. Janë konstatuar **5 raste** të kultivimit të bimëve narkotike, të zbuluara: **1 rast** në territorin e bashkisë Korçë (me 1 bimë të mbjellë në një kasolle të braktisur), **1 rast** në fshatin Voskop (me 2 bimë të mbjella në tokë private), **1 rast** në fshatin Jallë, Njësia

Administrative Velçan, bashkia Pogradec (me 610 bimë të mbjella në zonë pyjore), **1 rast** në vendin e quajtur “Uji i ftohtë” Njësia Administrative Velçan, bashkia Pogradec (me 128 bimë të mbjella në zonë pyjore) dhe **1 rast** në fshatin Dushar, Njësia Administrative Moglicë, bashkia Maliq (me 3 bimë të mbjella në pyll). Janë arrestuar 4 persona dhe 1 i shpallur në kërkim.

Janë ngritur 1 602 grupe kontrolli, dhe janë ushtruar 20 939 kontrolle të objekteve të ndryshme, si serra, depo e objekte të tjera, ish depo ushtarake e tunele, shtëpi të braktisura, stalla/stane, ambiente të hapura, ish parcela.

Janë zhvilluar 45 takime sensibilizuese.

#### 6. Komiteti Pilotues për Rihapjen e Liceut Francez në Korçë

Në 2024 është ngritur Komiteti Pilotues për rihapjen e Liceut Francez në Korçë si dhe është hartuar nga Sekretariati Teknik regullorja e funksionimit të tij. Ky komitet është iniciuar nga kërkesa e z. Kryeministrit Edi Rama, pas takimit me Presidentin francez z. Emanuel Macron, gjatë vizitës së tij historike në vendin tonë. Për këtë qëllim në Gusht 2024 është atashuar në Prefekturë eksperti teknik ndërkombëtar z. Jerome Le Bars. Komiteti ka zhvilluar 2 takime: në takimin e parë të anëtarëve të tij është konsultuar dhe firmosur regullorja e funksionimit të komitetit ndërsa në takimin e dytë eksperti ka prezantuar rezultatet e studimit të realizuar në shkollat e qytetit.

### **IX: Sektori Juridik**

Në mbështetje të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin” i ndryshuar, objektivave të punës së institucionit dhe Sektorit Juridik në veçanti për vitin 2024, rregullores së brendshme të funksionimit si dhe detyrave specifike të dala gjatë vitit, Sektori Juridik në bashkëpunim me sektorët e tjerë në institucion ka patur si objekt kryesor të punës, realizimin me cilësi, në kohë dhe me përgjegjësi të detyrimeve që i janë ngarkuar institucionit të Prefektit.

Referuar objektivave të sektorit dhe planit vjetor të punës, çështjet më kryesore të trajtuara gjatë vitit 2024 janë:

- Kontrolli i bazueshmërisë ligjore të akteve me karakter normativ, të miratuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në Qarkun e Korçës duke u shprehur mbi përputhshmërinë ligjore të tyre.
- Verifikimi në vend i akteve me karakter normativ të Organeve të Vetëqeverisjes Vendore, sipas afateve të përcaktuara në lig dhe sa herë që paraqitet nevoja.
- Angazhimi i sektorit në lidhje me zbatimin e detyrimeve që i ngarkohen institucionit të Prefektit nga Kodi Zgjedhor, vendimet e urdhëresat e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve dhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në lidhje me procesin e zgjedhjeve parlamentare, të datës 11 Maj 2025.
- Angazhimi i sektorit në lidhje me regjistrimin e pronave në administrim të institucionit të Prefektit, bazuar në përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.28, datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”.
- Marrja nënshkrim dhe nxjerrja e vendimeve përkatëse lidhur me kërkesa që i janë paraqitur Prefektit të Qarkut për “Shpallje Dëshmor i Atheut”.
- Ndjekja e praktikave të adresuara nga Drejtoritë Vendore të Policisë në Qarqe mbi kërkesa për rifitim shtetësie.
- Vlerësimi dhe shprehja ligjore për praktika të ardhura nga Drejtoria Vendore e Policisë në qark, për rastet dhënies së masës administrative plotësuese për shkeljet e qarkullimit rrugor, (pezullim ose jo të lejeve të drejtimit).

- Korrespondenca me Zyrën e Bashkëqeverisjes në Kryeministri për praktika të adresuara nga qytetarë.
- Angazhimi nëpërmjet sistemit elektronik sa i përket deklarimit vjetor të pasurisë në ushtrimin e funksioneve publike për subjektet që mbartin detyrim ligjor për deklarim.
- Hartimi i urdhërave për ngritje komisionesh, drejtim task-forcë, si dhe urdhra të brendshëm për një funksionim normal të detyrimeve që i ngarkohen institucionit e administratës.
- Hartimi i qarkoreve dhe korrespondenca me institucione qendrore, vendore, Njësi të Vetëqeverisjes Vendore dhe qytetarë.
- Bashkëpunimi me sektorët e tjerë në institucion lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të pranuar nga institucioni, me qëllim rritjen e cilësisë gjatë ushtrimit të detyrave që ligji ngarkon.
- Bashkëpunimi me Nënprefektët në bashkitë e qarkut dhe sektorët e tjerë në institucion.

Arritje dhe problematika të konstatuara gjatë vitit 2024 lidhur me verifikimin e bazueshmërisë ligjore të akteve.

Nisur nga ky detyrim ligjor, referuar dispozitave të ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut” i ndryshuar dhe ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në qark për periudhën Janar-Dhjetor 2024 (6 Bashki dhe Këshilli i Qarkut) kanë depozituar pranë Institucionit të Prefektit për verifikimin e bazueshmërisë ligjore gjithsej 377 akte (Vendime me karakter normativ), me një mesatare mujore prej 31 aktesh në shkallë Qarku. Nga 337 akte të depozituara është konfirmuar bazueshmëria ligjore për 350 akte, ndërsa 28 janë kthyer si të pa mbështetura në ligj. Për periudhën Janar - Dhjetor 2024 nga NJVV-të në qark rezultojnë 12 akte të rishqyrtuara.

Gjatë vitit 2024 sektori është njohur edhe me 76 vendime të këshillave Bashkiakë për të cilat nuk jemi shprehur mbi bazueshmërinë ligjore pas konstatimit se këto akte, nuk i përmbushin elementët e aktit administrativ me karakter normativ sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

Sa më sipër edhe pse ndarja e natyrës së akteve (normative, kolektive dhe individuale) duhet të bëhet nga strukturat përgjegjëse në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, vihet re se një pjesë e bashkive të qarkut kanë vështirësi apo nuk marrin iniciativat ligjore për ndarjen e tyre, duke dërguar për verifikim të gjitha aktet e miratuara në mbledhjet e këshillave bashkiakë. Rastet e kontestimit të 28 akteve dhe kthimi i tyre për rishqyrtim, kryesisht ka të bëjnë me:

- Referimin e gabuar në ligj, shkak ndryshimet ligjore që i bëhen akteve ligjore dhe nënligjore. (ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, udhëzime, etj).
- Hartimi jo korrekt i aktit administrativ në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga ligji (Kodi i Procedurave Administrative); Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë nr. 6, datë 29.04.2022 “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”; manualët e hartimit të shkresave të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave; mospërcaktimi i kohës së hyrjes në fuqi dhe shtrirjes së efekteve juridike; mospërcaktimi i saktë i procedurave që duhet të ndiqen në vazhdim nga strukturat e NJVV-e.
- Miratimi i akteve nga organi jokompetent dhe depozitimi i tyre pa relacion sqarues të hartuar nga strukturat përgjegjëse që mbartin detyrimin ligjor në bashk, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 16 të ligjit për Prefektin e Qarkut.

Sa i përket referimit në ligj dhe afateve ligjore të depozitimit të akteve, vlerësojmë faktin se në krahasim me vitet e kaluara, bashkitë në përgjithësi treguan rritje të standarteve të punës dhe përgjegjësi që burojnë nga ligji nr.107/2016, “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjet e tjera në fushën e ushtrimit të

veprimtarisë së tyre, aktet e tjera normative nënligjorë, megjithëse ka patur një kthim më të lartë të akteve nga vitit 2023. Duke i bërë një krahasim analitik vitit 2024, me vitin 2022 dhe 2023, po paraqesim treguesit statistikore lidhur me verifikimin e bazueshmërisë ligjore dhe kthimin e akteve për rishqyrtim si të pambështetura në ligj.

Për vitin 2022 rezultojnë 32 akte të pabazuara në ligj dhe 9 të rishqyrtuara nga NJVV-të.

Për vitin 2023 rezultojnë 16 akte të pabazuara në ligj dhe 6 të rishqyrtuara nga NJVV-të.

Për vitin 2024 rezultojnë 28 akte të pabazuara në ligj dhe 12 të rishqyrtuara nga NJVV-të.

#### Verifikimi në vend i akteve me karakter normativ.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 janë kryer në kohë, verifikimet në vend të akteve të dala nga organi ekzekutiv dhe ai përfaqësues në gjashtë bashkitë dhe Këshillin e Qarkut. Në përfundim janë dhënë sugjerime e orjentime sa i përket përmirësimit të punës dhe procedurave që lidhen me afatet e njoftimit për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjeve të këshillave, mbajtja e proces-verbaleve dhe dokumentacionit të nevojshëm etj. Nga verifikimi në vend nuk rezultuan akte me karakter normativë të padepozituara për verifikim të ligjshmërisë pranë institucionit të Prefektit.

#### Mbi procesin e zgjedhjeve parlamentare të datës 11 Maj 2025.

Spektori Juridik në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm në institucion, ka marrë masat paraprake për plotësimin në kohë të gjitha detyrimeve që përcakton Kodi Zgjedhor lidhur me përfshirjen dhe rolin e institucionit të Prefektit në procesin para dhe pas zgjedhor i cili ka të bëjë me:

- Përcaktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit, selive të KZAZ-ve dhe vendeve të numërimit të votave; neni 93 i K.Zgjedhor;
- Përcaktimin e vendndodhjes dhe përgatitja e vendeve të numërimit të votave; neni 94 i K.Zgjedhor.
- Publikimi/afishimi i listës së kandidatëve, neni 73 i K.Zgjedhor.
- Njohja me vendimet e Kryetarëve të Bashkive lidhur me ndarjen ose bashkimin e qendrave të votimit, si dhe ndryshimet e adresave të qendrave të votimit, në përputhje me parashikimet e pikës 8 të udhëzimit të Ministrisë të Brendshme nr. 235, datë 10.12.2024 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë”.
- Marrja e masave dhe ngritja me urdhër të Prefektit të grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor, në zbatim të Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator pranë KQZ “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

#### Vlerësimi i kërkesave të paraqitura me objekt “Shpallje Dëshmor i Atdheut” dhe atyre për “ndryshim emri”.

Spektori juridik për vitin 2024 është njohur me një ankim për “Shpallje Dëshmor i Atdheut” dhe për këtë me urdhër të Prefektit ka vënë në lëvizje komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e saj bazuar në kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 109/2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”. Në përfundim komisioni vendor për shqyrtimin e kërkesave i ka relatuar Prefektit të Qarkut lidhur me marrjen e vendimit përfundimtar.

Praktika të adresuara nga Drejtoria Vendore e Policisë në Qark për kërkesa me objekt, rifitim shtetësie dhe për vlerësim të masës administrative plotësuese për shkeljet e qarkullimit rrugor, për pezullim të lejeve të drejtimit.

Për këtë detyrim ligjor, sektori juridik ka ndjekur me vëmendje rastet e adresuara për rifitim shtetësie duke bërë të gjitha verifikimet përkatëse si dhe ka kërkuar nga Zyrat e Gjendjes Civile në bashki dokumentacion provues lidhur me vërtetësinë e fakteve të paraqitura. Gjithashtu janë përmbyllur brenda afateve ligjore të gjitha praktikat e adresuara nga DVP Korçë për rastet e vlerësimit të masave administrative pezullim të lejeve të drejtimit, si masë plotësuese për shkeljet në fushën e qarkullimit rrugor.

Lidhur me korrespondencën e shkresave administrative

Sektori juridik, gjatë vitit 2024 është njohur, ka përpunuar dhe ka përgatitur një numër të konsiderueshëm të shkresave administrative që kanë të bëjnë me praktikat e adresuara në institucion, (pa përfshirë këtu materialet/praktikat ku specialistet e sektorit asistojnë mbështetjen ligjore në sektorët e tjerë). Në bashkëpunim me sektoret e tjerë të institucionit, kemi ndjekur me vëmendje të veçantë korrespondencën mbi problemet dhe ankesat e qytetarëve në drejtim të institucioneve qëndrore në nivel vendor dhe Nj.V.V-ve. Në këtë drejtim nga ana e specialistëve të sektorit u është dhënë zgjidhje si dhe janë dhënë orjentime e këshillime ligjore shtetasve dhe institucioneve që janë adresuar pranë institucionit të Prefektit të Qarkut.

Sektori juridik, (specialisti përgjegjës) gjatë këtij viti ka ndjekur zbatimin e rregullores “Përparandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë, duke ndjekur nga afër edhe procesin e deklarimit të interesave private për subjektet që mbartin detyrim për deklarim.

Bashkëpunimi me Sektorët e tjerë të institucionit dhe Nënprefekturat.

Për shkak të natyrës sëpunës dhe zbatimit të objektivave të sektorit, gjatë vitit 2024 është bashkëpunuar me Sektorin e Finances dhe Shërbimeve Mbështetëse, në drejtim të:

- Hartimit të projektbuxhetit vjetor të institucionit për vitin 2025.
- Hartimit të urdhërave/urdhëresave me karakter financiar.
- Hartimit të urdhërave për nëpunësit dhe punonjësit mbështetës të institucionit.
- Ofrimit të asistencës për konceptimin e materialeve shkresore drejtuar Departamentit të Administratës Publike, të cilat lidhen me ligjin për Nëpunësin Civil.

Me sektorin e Zhvillimit Urban është bashkëpunuar në lidhje me :

- Verifikimin e akteve normative të miratuara nga NjVV-të që i përkasin zhvillimit urban, investimeve dhe Planifikimit të Territorit.
- Evidentimin dhe ndjekjen e rrugës ligjore për zgjidhje të problematikave të tjera të adresuara në Sektorin e Zhvillimit Urban, të cilat lidhen me funksionimin e disa Task-Forcave të ngritura nga Prefekti i Qarkut,
- Dhënien e orientimeve ligjore për problematika të ndryshme të adresuara në këtë sektor.

Me sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve e Deleguara kemi patur një bashkëpunim të gjerë sa i përket:

- Verifikimit të akteve me karakter financiar (paketat fiskale, buxhetet, implementimi i projekteve, akordim apo ndryshim destinacion fondesh nga bashkitë apo Këshilli i Qarkut).

- Verifikimit të akteve normative në fushën e kompetencave vendore që kanë bashkitë dhe Këshilli i Qarkut (nenet 21-33 të Ligjit 139/2015).

Me sektorin e Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave kemi bashkëpunuar lidhur me:

- Verifikimin e ligjshmërisë së akteve për dhënie ndihme financiare në raste fatkeqësish (djegie banese, përmbytje, fatkeqësi familjare etj), duke dhënë orientime në lidhje me hartimin e dokumentacionit të nevojshëm deri në miratimin e vendimeve nga këshillat bashkiakë, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr.49/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, V.K.M-së Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 8.7.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” të ndryshuar.

- Konceptimin e materialeve që kanë të bëjnë me shqetësime apo ankesa të cilat lidhen me fatkeqësi të ndryshme natyrore, për të cilat kërkohet interpretim ligjor.

Bashkëpunimi me Nënprefekturat:

Sektori Juridik ka patur bashkëpunim edhe me Nënprefekturat Pogradec, Kolonjë dhe Devoll si pjesë përbërëse e administratës së Prefektit, të cilat në disa raste kanë përcjellë pranë institucionit të Prefektit (sektorit juridik) problematika të ndryshme për zgjidhje që kishin të bënin me institucione shtetërore në nivel vendor dhe me qytetarë.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 nga ana e Sektorit Juridik, janë përgatitur dhe dërguar në kohë pranë Ministrisë së Brendshme edhe evidencat mujore të akteve të Nj.V.V-ve.

## **X: Sektori i Zhvillimit Urban**

Sektori i Zhvillimit Urban ka përgjegjësi të verifikojë, kontrollojë dhe të marrë masa për zbatimin e programit të qeverisë dhe plotësimin e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fushat e Territorit, Infrastrukturës, Mjedisit dhe Investimeve.

Objektivat e përgjithshme të punës së Sektorit, të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Institucionit dhe të miratuara nga Prefekti i Qarkut, për vitin 2024 janë:

1. Të bashkërendojë dhe monitorojë veprimtarinë e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Degëve Territoriale për të siguruar një zhvillim urban dhe ruajtje të mjedisit brenda kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.
2. Të krijojë kushte për një zhvillim të qëndrueshëm të territorit sipas parimeve të Ligjit Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nivel qarku.
3. Të planifikojë programe e masa për garantimin e rigjenerimit urban, mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore e hapësirave të gjelbra.
4. Të bashkërendojë veprimtarinë e administratës shtetërore në qark për respektimin e planeve rregullues, masterplaneve dhe studimeve të pjesshme urbane, si dhe bashkërendimin e këtyre studimeve me politikat e zhvillimit të qeverisjes qendrore.
5. Të sigurojë në nivel Qarku marrjen e masave për mbajtjen pastër të mjedisit, pastrimin e parqeve, lulishteve, hapësirave të gjelbra publike si dhe mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta shtëpiake.
6. Të sigurojë në nivel Qarku, marrjen e masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.

7. Të ndjekë ecurinë e investimeve në nivel Qarku dhe prioritizimin e tyre sipas kërkesave e nevojave.

Bazuar në objektivat e vendosura, Sektori i Zhvillimit Urban gjatë vitit 2024, ka trajtuar të gjitha shkresat e hyra në Institucion, të cilat kishin të bënin me fushën e Territorit, Infrastrukturës, Mjedisit e Investimeve.

Gjatë kësaj periudhe, janë trajtuar në total 47 (*dyzet e shtatë*) *korrespondenca* në fushën e bashkëpunimit me Qeverisjen Qendrore, Degët Territoriale që veprojnë në Qark dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Këtu përfshihen kërkesa për bashkëpunim, kërkesa për ndërhyrje dhe zbatim ligjshmërie, kërkesa për informacione, vlerësime informacionesh, kthim përgjigje, trajtime ankesash të shtetasve, si dhe shkëmbime të informacioneve të nevojshme në kuadër të zbatimit të ligjeve dhe detyrave funksionale nga çdo strukturë. Janë konfirmuar 5 (*pesë*) *genplane* objektesh për privatizim, në zbatim të V.K.M. Nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes” dhe Udhëzimit Nr. 5380, datë 20.07.2011, “Për procedurat e shitjes me ankand publik të aseteve të shoqërive anonime me kapital shtetëror në likuidim”. Në bashkëpunim me Sektorin Juridik janë verifikuar 34 (*tridhjetë e katër*) *vendime të Këshillave Bashkiakë* në fushën e Territorit, Infrastrukturës, Mjedisit e Investimeve.

Janë përpiluar rregullisht në mënyrë periodike planet dhe informacionet mujore të punës, informacionet javore, informacionet mujore për veprimtarinë e Degëve Territoriale në fushën përkatëse, si dhe Analiza Vjetore e Punës së Sektorit, Plani Vjetor, Objektivat e Punës së Sektorit dhe Manuali i Proceseve të Punës në fillim të vitit kalendarik.

Aspekte të rëndësishme të punës të S.ZH.U-së për vitin 2024, kanë qenë:

**I. Komiteti i Menaxhimit të Zonës të Mbrojtur Mjedisore “Parku Kombëtar i Prespës”**: Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë në bashkëpunim me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura Korçë, në zbatim të përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr. 107/2016, "Për Prefektin e Qarkut", Ligjin Nr. 81/2018, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 593, datë 09.10.2018, “Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore”, ka zhvilluar takimin e Komitetit të Menaxhimit të Zonës të Mbrojtur Mjedisore “Parku Kombëtar i Prespës”, në datën 09.05.2024.

Në përfundim të këtij takimi nga diskutimet dhe sugjerimet e bëra nga anëtarët pjesëmarrës u nxorën disa konkluzione, si më poshtë:

- a) Bazuar në ndryshimet që sjell Ligji Nr. 21/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, u kërkuar që në kontratat e kullotave të cilat me ligjin e ri do të menaxhohen nga Bashkitë, të fillohet nga puna për daljen sa më shpejt të udhëzimit të ri në mënyrë që të trajtohen kërkesat e blektorëve.
- b) Të ketë fokus të veçantë zhvillimi i orëve mjedisore dhe përfshirja e sa më shumë shkollave të qarkut.
- c) Të tregohet kujdes për mbrojtjen e Zonave të Mbrojtura nga zjarret.
- d) Të rritet kujdesi dhe t’i jepet ndihma turistëve/vizitorëve që do të kenë nevojë nga stafi i terrenit të AdZM-së.
- e) Të bëhet rinovimi i shtigjeve, tabelave orientuese/informuese në lidhje me zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës.
- f) Në kuadër të nismave e qëllimeve të përbashkëta, të ketë gjithmonë bashkëpunime dhe të identifikohen burime financiare me fokus primar hartimin e Planeve të Menaxhimit për Zonat e Mbrojtura.



**2. Komiteti i Menaxhimit të Zonës të Mbrojtur Mjedisore “Peisazhi i Mbrojtur Tokësor, Ujor i Pogradecit”:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë në bashkëpunim me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura Korçë, në zbatim të përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjin Nr. 81/2018, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, VKM Nr. 593, datë 09.10.2018, “Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore” dhe VKM Nr. 597, datë 25.09.2024, “Për shpalljen “Peisazh i mbrojtur Ujor/Tokësor” (Kategoria V) të Liqenit të Pogradecit”, ka zhvilluar takimin e Komitetit të Menaxhimit të Zonës të Mbrojtur Mjedisore “Peisazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor” i Liqenit të Pogradecit, në datën 17.10.2024.

Në përfundim të takimit të K.M.Z.M-së “Peisazhi i Mbrojtur Tokësor, Ujor i Pogradecit”, është konkluduar si më poshtë vijon:

- a) Të merren masa për përfundimin e Planit të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur Mjedisore “Peisazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor”, i Liqenit të Pogradecit.
- b) Të zhvillohen takime të përbashkëta me institucionet përgjegjëse, sipas fushës të përgjegjësisë, për trajtimin e problematikave të konstatuara nga AdZM në zonën e mbrojtur.
- c) Të merren iniciativa të cilat lenë një produkt konkret dhe promovim i këtyre produkteve dhe i zonave të mbrojtura në përgjithësi.
- d) Të ndiqen problematikat lidhur me mbylljen e dampave dhe të rritet monitorimi nga AdZM por edhe institucionet e tjera, për parandalimin e aktiviteteve të paligjshme në zonat e mbrojtura.
- e) Të rritet bashkëpunimi ndërinstitucional me synim arritjen e objektivave të përcaktuara në legjislacionin shqiptar për Zonat e Mbrojtura.

### **3. Menaxhimi i mbetjeve:**

Organizimi i Menaxhimit të Mbetjeve sipas bashkive të Qarkut është si më poshtë:

1. **Bashkia Korçë:** Shërbimi i pastrimit kryhet nëpërmjet kontraktimit me palë të tretë, (subjekti “Korsel” shpk), me objekt: pastrimin e rrugëve dhe trotuareve, lagjen e rrugëve, evadimin e mbetjeve dhe transportin e tyre në lëndfill, (vend-depozitimin sanitar Maliq), evadimin e dëborës e hedhjen e kripës, si dhe grumbullimin dhe evadimin e mbetjeve nga fshatrat. Kontrata është lidhur në vitin 2023 me afat 3-vjeçar. Tarifat e pastrimit janë miratuar me VKB Nr. 153, datë 07.12.2023.
2. **Bashkia Pogradec:** Shërbimi i pastrimit kryhet nëpërmjet kontraktimit me palë të tretë, (subjekti “REI” shpk). Kontrata është lidhur në datën 30.07.2020 me afat 5-vjeçar. Tarifat e pastrimit janë miratuar me VKB Nr. 133, datë 11.12.2023.
3. **Bashkia Maliq:** Shërbimi i pastrimit kryhet nëpërmjet kontraktimit me palë të tretë, (subjekti “Korsel” shpk). Tarifat e pastrimit janë miratuar me VKB Nr. 136, datë 26.12.2023.
4. **Bashkia Devoll:** Shërbimi i pastrimit kryhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të Bashkisë. Mbetjet grumbullohen për 24 orë në Stacionin e Transferimit dhe më pas kalojnë në lëndfill. Tarifat e pastrimit janë miratuar me VKB Nr. 95, datë 30.11.2023.
5. **Bashkia Kolonjë:** Shërbimi i pastrimit kryhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të Bashkisë. Mbetjet grumbullohen për 24 orë në Stacionin e Transferimit Ersekë dhe më pas kalojnë në lëndfill, ndërsa mbetjet e Leskovikut

depozitohen në vend-grumbullimin e mbetjeve Leskovik. Tarifat e pastrimit janë miratuar me VKB Nr. 127, datë 24.11.2023.

6. Bashkia Pustec: Shërbimi i pastrimit kryhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të Bashkisë. Mbetjet depozitohen çdo ditë në vend-depozitimtar sanitar Maliq (lendfill). Tarifat e pastrimit janë miratuar me VKB Nr. 86, datë 22.12.2023.

4. Task-Forca mbi Qeset Plastike Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 35, datë 19.02.2024, “Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Task-Forces për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe të qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme”, jemi angazhuar për marrjen e informacionit nga Bashkitë e Qarkut lidhur me adresat e tregjeve Agro-Ushqimore që operojnë në bashki, si dhe për personin përgjegjës për mbarëvajtjen e punës gjatë inspektimit. Në këtë kuadër kemi organizuar dhe kemi marrë pjesë në takimin e zhvilluar në Prefekturë në datë 16.04.2024, me drejtuesit e Policive Bashkiake të Bashkive të Qarkut Korçë dhe përfaqësues të Task-Forcës nga Inspektorati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ku u diskutua për ecurinë e procesit. Gjithashtu në fillim të muajit Dhjetor 2024 ju kemi drejtuar Bashkive të Qarkut me kujtesën për monitorimin e tregjeve gjatë fundvitit, në zbatim të VKM përkatëse (Nr. 367/2022), mbi përdorimin e qeseve plastike mbajtëse nga ana e personave apo subjekteve që importojnë, përdorin dhe i ofrojnë konsumatorit këto produkte.

5. Realizimi i investimeve viti 2024: Nga Sektori i Zhvillimit Urban është ndjekur ecuria e realizimit të investimeve në Qarkun e Korçës nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshilli i Qarkut dhe është dërguar çdo 4 muaj evidenca përkatëse në Ministrinë e Brendshme.

Drejtime të tjera të punës së Sektorit të Zhvillimit Urban gjatë vitit 2024 kanë qenë:

- Në kuadër të aksioneve të pastrimit të territoreve që nuk mbulohen nga shërbimi i përditshëm nga Bashkitë dhe pas kërkesës së Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit, është kërkuar informacion për planizimin e këtyre aksioneve nga Bashkitë e Qarkut dhe janë marrë informacionet përkatëse në bazë mujore. Bashkitë e Qarkut kanë evidentuar pikat problematike në territoret e tyre dhe kanë kryer ndërhyrje me mjete e punonjësit e shërbimeve për heqjen e mbetjeve.
- Në kuadër të inspektimeve të Drejtorisë Rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në subjektet ndërtuese që kryejnë investime publike në Bashkitë e Qarkut, është kërkuar bashkëpunimi i këtyre Bashkive për këshillimin ndaj firmave ndërtuese, lidhur me zbatimin e kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Problemet që Sektori i Zhvillimit Urban ka hasur gjatë vitit 2024:

Vonesat në kthimin e përgjigjeve zyrtare, vështirësi në shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunim institucional me Institucionet, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe Njësitë Administrative, e cila sjell uljen e efikasitetit të zbatimit të detyrave të përcaktuara. Mendojmë që për zgjidhjen e shumë problematikave të ndeshura duhet të organizohen takime në Institucionin e Prefektit me përfaqësues të Degëve Territoriale, Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore dhe sipas rastit me specialistë të fushave përkatëse.

Në punën e Sektorit ka ndikuar edhe mangësia në stafin e tij si pasojë e vakancës së krijuar në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit prej një viti dhe vonesës në shpalljen e këtij vendi nga DAP. Për pasojë detyrat e Përgjegjës të Sektorit i janë

deleguar me urdhër të Titullarit Specialistit të Territorit dhe Infrastrukturës gjë që ka mbingarkuar punën e Sektorit në terësi.

### **XI: Zyrat e Arkivit të Gjendjes Civile:**

Në zbatim të Ligjit Nr.10 129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile” nga ana e Zyrave të Arkivit të Gjendjes Civile në Institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë, gjatë vitit 2024 janë marrë masa për zbatimin në mënyrë sa më efikase të tij dhe është punuar rregullisht dhe sistematikisht duke respektuar çdo detyrim ligjor.

Nga data 01.10.2023 në vijim të nismës së ndërmarrë nga qeveria shqiptare për mbylljen e sporteve fizike dhe ofrimin e shërbimeve on-line edhe certifikatat historike dhe aktet që Zyrat e Arkivave të Gjendjes Civile disponojnë lëshohen vetëm elektronikisht. Z.A.GJ.C-të bëjnë përpunimin e kërkesave të qytetarëve të adresuara nëpërmjet portalit qeveritar e-albania brenda 3 (tre) ditëve pune. Përfundim nga sa më sipër përbëjnë vetëm shtetasit e huaj, të cilëve u është mbajtur akti në zyrat tona.

Gjatë vitit 2025 Z.GJ.C kanë lëshuar: **25 620 certifikata on line** dhe **15 certifikata nga sportelet fizike**, në total **25 635 certifikata**:

Nr.	Zyrat e Gjendjes Civile të Arkivës	Dok të lëshuara nga sportel on-line	Dok të lëshuara nga sportel fizike	TOTAL
1	Z. GJ. C Arkivi Korçë	10 800	0	10 800
2	Z. GJ. C Arkivi Pogradec	7 500	15	7 515
3	Z. GJ. C Arkivi Devoll	6 280	0	6 280
4	Z. GJ. C Arkivi Kolonjë	1040	0	1 040
	<b>TOTAL</b>	<b>25 620</b>	<b>15</b>	<b>25 635</b>

Tab. 2 Numuri i dokumentave të lëshuara nga Zyrat e Gjendjeve Civile Qarku Korçë - 2024

Domosdoshmëri ngelet riparimi i regjistrave themeltarë dhe akteve të lindjeve-martesave-vdekjeve, nevoja për rikonstrukcion të ambienteve, rrjetit elektrik, mungesa e materialeve kancelari, mungesa e internetit, riparimet e ndryshme në pajisjet kompjuterike (kompjuter, printer) etj.

### **XII: Problematikat:**

Disa nga problematikat e konstatuara nga puna gjatë vitit 2024, të cilat pavarësisht korrespondencave e ndjekjes të vazhdueshme, nuk gjetën zgjidhje janë:

- Vonesat në kthimin e përgjigjeve zyrtare nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore;
- Shtesa e fondeve në artikullin 231 (investime), për të realizuar disa nga nevojave që ekzistojnë në institucion, zëvendësimi i paisjeve të vjetra kompjuterike/elektronike dhe pajisje për ngrohje për disa zyra dhe Nënprefekturat.
- Shtesë në organikë të një punonjësi IT, si për mirëmbajtjen e rrjetit kompjuterik ashtu edhe për mirëmbajtjen e faqes zyrtare. Nga AKSH-i jemi informuar me shkresë zyrtare se nevoja për një punonjës të tillë në institucion është detyrim ligjor.

- d) Përmirësimi cilësor i punës së institucionit nëpërmjet pajisjes më të mirë me mjete, pajisje të teknologjisë dhe kualifikime e trajnime të stafit, në funksion të modernizimit dhe rritjes së cilësisë së punës.
- e) Nënprefektura Pogradec: Disa nga problematikat e përmbledhura që kërkojnë zgjidhje:
- Problemi i rrugëve rurale në zonën e Mokrës dhe të Gorës.
  - Problemi i energjise elektrike në njësitë administrative Dardhas dhe Proptisht.
  - Transferimi i mbetjeve minerale nga dampa në Gurin e Kuq.
  - Shpronësimet në unazën e qytetit.
  - Likuidimi i familjeve që ju kanë ndodhur fatkeqësi natyrore.
  - Problemi i librave të trojeve të disa fshatrave, vonesat në marrjen e certifikatave të pronësisë, problemet e tokave bujqësore në Kalivaç, Proptisht, Piskupat.
  - Çmimi i lartë i imputeve bujqësore, ndërhyrje në rrugët e parcelave, problemi i vaditjes.
  - Vazhdimi i fazës së dytë të 20 kw.
  - Zhvendosja e dokumentacionit të Nënprefekturës, prane arkivës së Prefekturës.
- f) Nënprefektura Devoll: Disa problematika të përmbledhura që kërkojnë zgjidhje:
- Pastrimi i rrugëve rurale, hapja e kanaleve vaditëse dhe çakullimi i rrugëve të arave në Bashkinë Devoll vazhdon të mbetet një problem i rëndësishëm.
  - Vonesa të shumta në nxjerrjen e certifikatave të pronësisë (legalizimeve) për shtëpitë e ndërtuara para vitit 1991 dhe për legalizimet e reja.
  - Vijat e bardha dhe sinjalistika rrugore mungojnë në rrugët kryesore dhe të brendshme, veçanërisht pranë shkollave, çka e bën ndërhyrjen të domosdoshme.
  - Ndërtimi ose gjetja e një ambienti për kafshët endacake, të cilat shpeshherë përbëjnë një shqetësim të madh për qytetarët.
  - Hapja e rrugëve malore për të lehtësuar qarkullimin e mjeteve zjarrfikëse në rastet e rënies së zjarreve.
  - Rishikimi i linjës elektrike të fiderit 8 (Bilisht-Arrzë), një problematikë e hershme që kërkon zgjidhje.
  - Nxitja e banorëve të fshatrave të Devollit të Sipërm (me politika lehtësuese nga Bashkia Devoll) për ngritjen e kapaciteteve pritëse për turistët.
  - Shtrimi me asfalt i rrugës Vidohovë-Miras.
  - Ndërhyrje në urën në hyrje të fshatit Progër, një problematikë e ngritur nga administratori i zonës për amortizimin e saj dhe rrezikshmërinë në kalimin e mjeteve.
  - Politika që nxisin bashkimin e fermerëve, duke krijuar më shumë mundësi për të përfituar nga skemat e mbështetjes financiare nga qeveria.

### **XIII: Objektivat 2025:**

- 1- Rritja e performancës së institucionit dhe përmirësimi i proceseve të komunikimit duke përdorur mundësitë që ofron teknologjia, për të rritur shpejtësinë e reagimit në rastet e nevojave emergjente.
- 2- Në kuadër të bashkëpunimit me NJVV-të, të rrisim nivelin cilësor të zgjidhjeve rajonale dhe shkallën e bashkëpunimit me institucione të qeverisjes qëndrore në nivel lokal, përfshirë një ndërveprim shumë aktiv me Universitetin “Fan S. Noli”.
- 3- Koordinimi i punës dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet shtetërore në nivel vendor në funksion të realizimit të objektivave dhe prioriteteve të përcaktuara në Strategjitë Kombëtare për vitin 2025 nga Qeveria Shqiptare.
- 4- Ndjekja në vazhdimësi e zbatimit të akteve ligjore dhe normative të Këshillit të Ministrave, urdhërave të Kryeministrit në fushat e përgjegjësisve të ndryshme institucionale.
- 5- Verifikimi rigoroz i ligjshmërinë së akteve të miratuara nga organet e qeverisjes vendore, bashki e qark, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prefektin.
- 6- Bashkëpunimi me institucionet e tjera përgjegjëse për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga pakujdesia dhe veprimtaria njerëzore, në funksion të Mbrojtjes Civile të popullatës.
- 7- Takime me fokus mbështetjen në sektorët prioritarë, si bujqësi, shëndetësi, arsim, turizëm dhe ato sociale.
- 8- Njohja sistematike e problematikave të terrenit që vijnë nga komunikimet dhe kontaktet e drejtpërdrejta me qytetarët. Në këtë kuadër edhe një rol më proaktiv të n/prefektëve dhe gjithë sektorëve të institucionit.
- 9- Vazhdimi i punës për realizimin në kohë të detyrave që lihen nga takimet e Komiteteve respektive, si dhe detyrimeve të deleguara nga anëtarët e Këshillit të Ministrave, si psh Paketa e Sigurisë në Shkolla, aksioni kombëtar i pastrimit, masat për mbrojtjes e territorit, të pyjeve etj.
- 10- Forcim i komunikimit e ndërveprimit edhe me aktorë të tjerë të shoqërisë përveç institucioneve shtetërore, si sipërmarrjet, shoqërisë civile, grupeve të interesit, komuniteteve qytetarë që jetojnë në zona urbane dhe rurale.
- 11- Pasqyrimi aktiv i rolit të institucionit të Prefektit të Qarkut në mediat sociale dhe ato lokale e kombëtare.
- 12- Përcaktimi i kalendarit të inspektimeve në terren për vitin 2025 lidhur me projektet e investuara nga qeveria e jo vetëm, e koordinuar me nënprefektët respective.
- 13- Takime të herëpashershme të drejtpërdrejta me komunitete të njësisve administrative të qarkut, për të dëgjuar shqetësime nga qytetarë dhe adresuar zgjidhje pranë institucioneve relevante.
- 14- Zhvillimi i aktiviteteve me prani të përbashkët të Prefektit dhe nënprefektëve me Policinë e Shtetit, pjesëmarrje në takimet ndërgjegjësuere me komunitete, vijimi i nismës për dhurimin e gjakut si aktivitet i zhvilluar për dy vite radhazi, etj.
- 15- Bashkëpunim me institucionet e qeverisjes qëndrore për zgjidhjen apo përgjithësimin sipas rastit, të problematikave të sektorëve të ndryshëm të jetës publike e ekonomike, që mund t'i shërbejnë vendimmarrjes.
- 16- Ndjekja me prioritet e detyrimeve institucionale që përcakton Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë dhe përcaktimet e tjera ligjore e nënligjore, në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të 11 Majit.